На прашањето - „Како ја замислувате АСЈО развојно? Имате ли Ваши сугестии за работата на АСЈО?“, испитаниците одговориле дека АСЈО ја замислуваат институционално зајакната, со подобрени објективни услови за работа и со зајакнување на човечките ресурси. Од неа се очекува да биде институција која со поголема динамика и транспарентност ќе создава кадри за судии и јавни обвинители и проактивно ќе ги следи потребите за континуирана едукација. Притоа, кадрите кои ќе се продуцираат да бидат високостручни и да ги следат модерните едукативни програми на европските институции од ваков карактер. Се очекува да се организираат специјализирани обуки за информатичарите, да има едукации за односи со јавноста, за менаџментот на судовите, градење на интегритет и самостојност како и етичко постапување во работата и слично. Се предлага да се оствари креирање и инвестирање во база на постојани едукатори; поголем дел од обуката да биде практична; да се зголеми надоместокот на едукаторите и соработката со домашни и странски образовни институции.

Испитаниците приоритетно посакуваат АСЈО набрзо да биде сместена, по можност, во нова зграда, соодветна на потребите, да се зголемат човечките ресурси кои организациски полесно ќе ги задоволат потребите на слушателите и да биде обезбеден поголем буџет за неа. Зградата да биде лоцирана во посебен дел од градот, со предавални, свечена сала, судници, соби за сместување на кандидатите и др.

Заклучни согледувања од одговорите на претставници од институциите поврзани со Академијата за судии и јавни обвинители „Павел Шатев“

- Висок процент на мнозинство од околу 88% испитаници сметаат дека АСЈО е потребно да постои, од кои 66% сметаат дека се отворила на време.
- Повторно околу 80% изразиле задоволство од квалитетот на кадрите кои излегуваат од АСЈО.
- Испитаниците побараа приемниот испит во АСЈО да се ревидира во смисла критериумите да бидат повисоки и да има посебни критериуми за прием на слушатели од редот на стручни соработници од судовите и обвинителствата; да се бара високо познавање на странски јазик и да се унапреди проверката за интегритетот; изборот на нови слушатели да биде по апелациони подрачја.
- Континуираната обука да се унапреди со обврзни сугестии на крајот од секоја година од секое апелационо подрачје; предавачите да се избираат според компетентност и квалитет.
- За почетната обука повеќе практика и симулации на судења.
- Подобра кадровска екипираност на АСЈО.
- Подобри просторни можности (нова зграда) за АСЈО.

Библиографија

1. Закон за Академијата за судии и јавни обвинители, „Службен весник на РМ“ број 20/2015, 192/2015, 231/2015 и 163/2018.
2. Предлог на Закон за Академијата за судии и јавни обвинители, Министерство за правда (ЕНЕР), 2019 година.
3. Подзаконски акти на АСЈО.
4. Програма за работа на АСЈО „Павел Шатов“ за 2019 година.
5. Програми за обуки (општи и специјализирани), извештаи, модули за обука, каталози на обуки, планови, статистики и други документи на тековното работење на АСЈО.
6. Функционална анализа на АСЈО, Скопје, 2019.
7. TAIEX Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.
8. Анализа на спроведувањето на итните реформски приоритети во македонското правосудство со Прилог-резултати од анкета за АСЈО, Проект „Заедничка акција за итни реформи во правосудството“, ФООМ, мај 2018 година.
9. Стратегија за реформа на правосудниот сектор за периодот 2017-2022 со Акциски план, Министерство за правда на Република Северна Македонија.
10. Стратешки план на Министерството за правда 2017-2019, Министерство за правда на Република Северна Македонија.
11. Стратешки план на судската власт за периодот 2020-2022 година, Судски буџетски совет, јули 2019.
12. Извештај во сенка за Поглавје 23, за периодот јуни 2018 - мај 2019 година, Мрежа 23, 2019 година.
13. Прв национален извештај од матрицата на индикатори за мерење на перформансите и реформите во правосудството, Центар за правни истражувања и анализи, февруари 2019 година.

14. Анализа на спроведувањето на стратегијата за реформа на правосудниот сектор (2017-2022) за периодот 2018-2019 година, Блупринт група за реформи во правосудството, Скопје 2019 година.
15. Анализа на резултатите од пилотирањето на матрицата за мониторинг на перформансите во правосудството ЦПИА, 2018.
16. Пристапувањето на Република Северна Македонија во ЕУ: Заслуги, придобивки и импликации, ФОО Скопје, мај 2019 година.
17. Communication From the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, European Commission, Communication on EU Enlargement Policy 2019.
18. Commission Staff Working Document, North Macedonia 2019 Report, European Commission.
19. Nine principles of judicial training of the European Judicial Training Network (EJTN) 2016.
20. Declaration of judicial training principles of the International Organization for Judicial Training (IOJT) 2017.
21. Експертски анализи од странски партнери на АСЈО (Франција, Германија) врзани со работењето на АСЈО.
22. Основни начела за независност на судството, одобрени со резолуциите на Генералното собрание на ОН 40/32 и 40/146 1985.
23. Европска повелба за законите за судиите, СЕ 1998.
24. Консултативен Совет на европските судии, Магна Карта за судиите (Фундаментални принципи) 2010.
25. Понатамошно јакнење на институционалните капацитети на АСЈО, IPA/2010/234-703 Прилог II, Извештај од потребите за обука.
26. Понатамошно јакнење на институционалните капацитети на АСЈО, IPA/2010/234-703 Прилог IX, Насоки за системот за контрола на квалитетот на почетната обука.
27. Понатамошно јакнење на институционалните капацитети на АСЈО, IPA/2010/234-703 Прилог VII, Насоки за системот за контрола на квалитетот на континуираната обука.
28. Процена на влијанието на регулативата за Законот за судови, ЕПИ Скопје, 2019.

29. Извештај за Република Северна Македонија за 2019 година, Брисел, 29.5.2019 година, СВД(2019) 218 конечна верзија.
30. Петровски, К., Драганов, М., ..., (2018), Анализа на спроведувањето на итните реформски приоритети во македонското правосудство, Институт за човекови права, Скопје.
31. Хорнунг, Р., (2016), Развој на стратешко планирање, потреби од обука и механизми за квалитативно оценување.
32. Аврамовски, Д., Амет, С., ... (2018), Анализата на спроведувањето на стратегијата за реформа на правосудниот сектор (2017-2022) за периодот од 2018/2019 година, Хелсиншки комитет за човекови права на Република Северна Македонија, Скопје.
33. „Службен весник на Република Северна Македонија“, бр. 96/2019.
34. „Службен весник на РМ“, бр. 88/02.07.2010.

Веб страници

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf,

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf,

<https://fokus.mk/samo-23-od-graganite-imaat-doverba-vo-sudstvoto/>,

<http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2019/02/PUBLIKACIJA-SDG-celosna-za-proverka-final-02.pdf>,

<https://akademik.mk/izveshtajot-na-ombudsmanot-vo-koj-se-notira-partiski-revanshizam-i-nedoverba-kon-sudstvoto-pred-komisijata-za-politichki-sistem/>,

<https://telma.com.mk/anketa-paga-doverbata-na-graganite-vo-sjo/>,

<https://civilmedia.mk/porazitlni-podatozi-graanit-n-im-vruvaat-na-sudstvoto-i-na-poliziata/>,

<https://telma.com.mk/deskovska-najavi-veting-sudiite-ne-prezemaanishto-za-kriminalot-vo-nivnite-redovi/>,

<https://rb.gy/tuuyxm>,

<https://fokus.mk/katsarska-da-se-sprovede-veting-ima-sudii-koi-ne-ja-zasluzhuvaat-sudiskata-toga/>,

https://denesmagazin.mk/deskoska-odgovornost-za-nestruchno-vodena-predmetite-vo-sudovite/?fbclid=IwAR11XLYngpzGpWra8mZM55t6_ejFvdILac5Yp5H0NoYJdCyPuEYqCd0m_bA,

<http://respublica.edu.mk/blog/2016-02-02-14-00-51>,

<https://meta.mk/biznismenite-so-namalena-doverba-vo-sudstvoto/>,

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf,

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf,

<http://www.pravda.gov.mk/toc1/94>,

<https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

Akademia për gjykatës
dhe prokurorë publik
“Pavel Shatev”

–

Analiza e pozicionimit aktual të
institucionit brenda sistemit dhe roli i tij
në trajnimin e stafit gjyqësor

Autorë:

prof. d-r Mirjana Najçevska

prof. d-r Natasha Gaber-Damjanovska

prof. d-r Bojana Naumovska, profesor inordinar

m-r Luan Imeri

Dizajni dhe botimi:

Polyesterday

Tirazhi:

150 kopje



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup

Përmbajtja

Hyrja	5
1. Gjendja aktuale e sistemit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut	6
2. Vendi i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev” në situatën momentale të sistemit gjyqësor dhe në procesin e ndryshimeve	9
3. Nevoja për ndryshime në punën e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev” - analizë dhe rekomandime	12
3.1. Organizimi i trajnimeve	14
3.2. Cilësi dhe përshtatje e trajnimeve	17
3.3. Matja e rezultatit të arritur	21
4. Zgjidhje të reja ligjore	25
Mendime përmbyllëse	27
Hulumtimi empirik i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	29
A. Pasqyrë e rezultateve të marra nga dëgjuesit në trajnimin fillestar të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	29
Vërejtje përmbyllëse të përgjigjeve nga dëgjuesit të tanishëm ose të mëparshëm të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	47
B. Pasqyrë e rezultateve të marra nga pjesëmarrësit në trajnimin e vazhdueshëm të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	49
Vërejtje përmbyllëse të përgjigjeve nga pjesëmarrësit e trajnimit të vazhdueshëm të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	63
C. Pasqyrë e rezultateve të marra nga përfaqësuesit e institucioneve lidhur me Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	64
Vërejtje përmbyllëse të përgjigjeve nga përfaqësuesit e institucioneve lidhur me Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”	69
Bibliografia	70
Ueb-faqe.....	72

Lista e shkurtesave

AGJPP	Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”
AKMIS	Sistemi informatik për menaxhim automatik të lëndëve gjyqësore
BE	Bashkimi Evropian
GREKO	Grupi i shteteve kundër korrupsionit në Këshillin e Evropës
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
HELP	Programi Evropian për edukim mbi të drejtat e njeriut për profesionistet e drejtësisë
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore
LPP	Ligji për procedurë penale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
TAIEX	Instrumenti për ndihmë teknike dhe këmbimin e informatave
VNT	Vlerësimi për nevoja të trajnimit

Hyrja

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev” (AGJPP) përfaqëson një institucion i cili ka rol kyç në procesin e përgatitjes fillestare dhe avancimin profesional të vazhdueshëm të personelit të gjyqësorit (para së gjithash atij gjyqtaro-prokurorial) në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pozicionimin e fortë sistemor që ka AGJPP e ka në kuptimin e asaj se përfaqëson të vetmin filtër përmes të cilit e kanë të obliguar kalimin kuadrot e reja, të cilët do të jenë të angazhuar në gjyqësor dhe prokurori, kërkon që t’i kushtohet vëmendje serioze cilësisë së shërbimeve të cilat ky institucioni i siguron dhe për këtë qëllim të bëhet një analizë serioze e gjendjes momentale dhe një projeksion për detyrat e ardhshme të punës të cilat duhet të vendosen si standarde afariste. AGJPP-ja edhe deri më tani, gjatë funksionimit të saj prej një dekade e gjysmë ka arritur rezultate të dukshme, që megjithatë, përfaqëson një bazë solide për rritje të mëtejme dhe zhvillim kapacitetesh, ndërsa e gjithë kjo në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gatishmërisë profesionale të kuadrit gjyqësor.

Njëri nga parametrat kyç përmes të cilit përcaktohet zhvillimi i shtetit në drejtim të standardeve të Bashkimit Evropian (BE-së) është sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Në secilin nga raportet e deritanishme të Komisionit Evropian (KE-së) për Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë këtu edhe raportin e fundit të majit, 2019¹, theksohet se “Vlerat themelore të BE-së përfshijnë sundimin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Funksionimi i drejtë i sistemit gjyqësor dhe lufta efikase kundër korrupsionit si dhe respektimi i të drejtave të njeriut në ligj dhe në praktikë janë të një rëndësie të madhe”. Në funksion të këtij përcaktimi të rëndësishëm strategjik dhe crucial, AGJPP ka për detyrë që në bashkëveprim me institucionet tjera - partnere, të vazhdojë në kuadër të kompetencave të saja të përafrojnë me përpjekjet e saja dhe punën për këtë qëllim të lartë. Në kornizat e saja të përgjithshme, nevojitet që të vendosen në mënyrë zhvillimore të mëtutjeshme të prioriteteve konkrete, të cilat do të investojnë në funksionimin e paanshëm, profesional, efikas dhe efektiv të gjyqësorit dhe do ta sigurojnë atë. Në mënyrë të pashmangshme, prioritetet e këtilla mund të realizohen, vetëm përmes potencialit cilësor kadrovik, i

1 Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2019, Bruksel, 29.5.2019, SWD(2019) 218 versioni final,

cili pritet të jetë formuar dhe arritur përmes punës së AGJPP-së. Një kuadër i tillë i ri, është përbërësi i cili do të sjellë reforma në “zemrën dhe mendjen” dhe në mënyrën e veprimit dhe të menduarit profesional në gjyqësor. Ai në vete duhet të mbartë idenë e përbashkët zhvillimore dhe misionin, të cilat dalin edhe nga atmosfera e përmirësuar cilësisht e cila gradualisht po krijohet në shoqëri.

Me qëllim që AGJPP-ja të planifikojë dhe pozicionojë si duhet prioritetet e saja zhvillimore, përmes mbështetjes dhe bashkëpunimit me Zyrën e Misionit të OSBE-së në Shkup është realizuar analizë e gjendjes momentale, shoqëruar me hulumtim empirik që plotëson gjetjet dhe rekomandimet e dhëna. Janë marrë parasysh një numër i dokumenteve, analizave dhe rekomandimeve strategjike që janë miratuar gjer më tani që kanë të bëjnë me sektorin e gjyqësorit në shtetin tonë dhe të cilat kanë pika të përbashkëta me punën e AGJPP-së.

Vijon analiza dhe rezultatet nga anketa e realizuar.

1. Gjendja aktuale e sistemit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pushteti gjyqësor është identifikuar si njëra nga shtyllat e rendit kushtetues të shtetit dhe garantues i sundimit të së drejtës dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit. Megjithatë, pikërisht sistemi gjyqësor u paraqit si njëra nga pikat e dobëta në procesin e integritimit të shtetit në BE, e bile ishte edhe i përmendur si element thelbësor në krizën në të cilën u gjet Republika e Maqedonisë së Veriut në periudhën prej vitit 2014 deri në 2016, dukshëm nga rezultatet që kishin të bëjnë me atë periudhë.

Në Raportin e grupit të posaçëm të ekspertëve të formuar nga ana e KE-së në 2015, theksohet se “Vendi ka një numër të rregullave gjithëpërfshirëse të cilat nëse përcillen plotësisht, në përgjithësi duhet të sigurojnë funksionim e duhur të sistemit gjyqësor sipas standardeve të larta, megjithëse ka nevojë për disa reforma të mëtutjeshme, sidomos në lidhje me emërimin, promovimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Gjykatës të trajnuar dhe me kualifikime të larta, prokurorë dhe nëpunës gjyqësor janë në dispozicion në numër të dukshëm për të siguruar që sistemi gjyqësor të funksionojë në mënyrë efikase”.² Në rekomandimet lidhur me sistemin

2 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf.

gjyqësor theksohet “Me qëllim që të siguron pavarësinë dhe në veçanti mungesën e ndikimit politik mbi vendimmarjen në prokurori dhe në gjyqësor, emërimi dhe promovimi i gjykatësve dhe prokurorëve do të jetë i depolitizuar. Emërimet dhe promovimet duhet të bëhen nga ana e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik sipas meritave transparente, objektive dhe kritere të bazuara në mënyrë rigorozë, ndërsa me përdorim të procedurave transparente të cilat duhet të vendosen me ligj dhe jo vetëm si rregulla interne, në pajtim me rekomandimet nga raportet e Komisionit të Venedikut për emërim të gjykatësve dhe pavarësinë e gjyqësorit [21] si dhe rekomandime specifike të përmbajtura në mendimet e dedikuara për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nga të cilat shumica nuk janë zbatuar [22]. Nuk duhet të lejohet vend për përkatësi partiake ose përkrahje si kriter për zgjedhje”.

Sipas Raportit të KE-së të fundit për përparimin e shtetit në procesin e aderimit drejt BE-së³, “Realizimi i kornizës së re ligjore siguron një bazë të fortë për ndryshim të përhershëm. Krahas ndryshimeve ligjore, është e rëndësishë thelbësore që të gjitha institucionet e gjyqësorit të jenë shembull dhe përmes përpjekjeve plotësuese të kontribuojnë për kthimin e besimit të popullit në gjyqësor” Sipas KE-së, në vitin e ardhshëm, ndër tjerash, vendi duhet “...të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të rregullave të reja për emrim, promovim, procedura disiplinore dhe shkarkim të gjykatësve dhe të tregojë se pavarësia e sistemit gjyqësor respektohet dhe promovohet në të gjitha nivelet, duke e mbrojtur kështu nga çdo rrezik i përzjerjes politike”.

Megjithatë, ajo që brengos është se besimi i qytetarëve ndaj sistemit gjyqësor mbetet edhe më tutje jashtëzakonisht i ultë, ndërsa procedurat të cilat ishin nisur nga Prokuroria speciale publike po zhvillohen me një tempo të ngadaltë, ndërsa dyshimet dhe procedurat e fundit për përzjerje të disa prokurorëve publik nga Prokuroria speciale publike në aktivitete të mëdha korrupsioni, vetëm kanë vërtetuar këtë qëndrim në opinion.⁴ Sipas të dhënave nga hulumtimi i ri për mendimin publik nga “Eurobarometar”, qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë besim të vogël tek gjyqësori (23%), por edhe në administratën publike, Qeverinë, parlamentin dhe partitë

3 Raport për Maqedoninë e Veriut për vitin 2019, Bruksel, 29.5.2019, SWD(2019) 218 versioni final

4 Besimi në gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është në nivel shumë të ultë, thonë nga shoqata ESE dhe Koalicioni Margini në Ditën evropiane për qasje tek drejtësia. Sipas të dhënave nga barometri evropian, vetëm 23% nga qytetarët e shtetit besojnë në gjyqësorin, 30% në administratën publike he 34% në policinë, <https://fokus.mk/samo-23-od-graganite-imaat-doverba-vo-sudstvoto/>, <http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2019/02/PUBLIKACIJA-SDG-celosna-za-proverka-final-02.pdf>, <https://akademik.mk/izveshtajot-na-ombudsmanot-vo-koj-se-notira-partiski-revanshizam-i-ne-doverba-kon-sudstvoto-pred-komisijata-za-politichki-sistem/>, <https://telma.com.mk anketa-paga-doverbata-na-graganite-vo-sjo/>

politike... më shumë se 50% nga qytetarët e anketuar kanë besim vetëm në Armatën (51%) edhe në BE-në (53%).⁵

Në këtë kontekst duhet të shikohen edhe paraqitjet e një pjese të funksionarëve të lartë në pushtet, bile edhe vetë gjykatësve, të cilët reagojnë në sjelljen e gjykatësve dhe prokurorëve publik, të cilën e vlerësojnë si të papërshtatshme, nënstandarde dhe si tregues i një niveli shumë të ultë të kulturës së gjyqësorit dhe të kuptuarit e rolit të sistemit gjyqësor në jetën shoqërore.⁶ Ky trend vërehet si vërejtje edhe tek subjektet tjera, siç është Oda e ndërmjetësve në Federatën e Odave ekonomike, të cilët deklaruan në konferencën e tyre për shtyp se “mosbesimi në sistemin gjyqësor po rritet, sundimi i së drejtës është njëra nga sfidat për të cilat alarmojnë edhe institucionet ndërkombëtare në raportet e tyre, ndërsa proceset gjyqësore zgjasin gjatë në mënyrë disproporcionale që është një shkak i pakënaqësisë tek bashkësia afariste.”⁷

Dosja maqedonase në Gjykatën e Strasburgut tregon se problemet e gjyqësorit në lidhje me pamvarësinë e saj në shumicën e rasteve janë të lidhura me “mosgatishmërinë e gjykatësve në fjalë të ballafaqohen me format e ndryshme të ndikimeve”⁸. Siç përmendet, nga shtatë lëndët e përfunduara gjer më tani⁹, në dy raste është problem imponimi i pushtetit ekzekutiv mbi atë gjyqësor, ndërsa në pesë raste anshmëria e gjykatësve.¹⁰

Përshtypja e këtillë e përgjithshme e cila del nga konstatimet e shumta të përmendura, dhe njëherë afirmon fuqishëm nevojën për të siguruar kuadro të reja cilësore gjyqësore, që do të punojnë sipas synimeve dhe parimeve shtetërore të parapara në strategjitë.

5 <https://civilmedia.mk/porazitlni-podatozi-graanit-n-im-vruvaat-na-sudstvoto-i-na-poliziata/>

6 <https://telma.com.mk/deskovska-najavi-venting-sudiite-ne-prezema-nishto-za-kriminalot-vo-nivnite-redovi/>, <https://rb.gy/tuuyxm>, <https://fokus.mk/katsarska-da-se-sprovede-venting-ima-sudii-koi-ne-ja-zasluzhuvaat-sudiskata-toga/>, https://denesmagazin.mk/deskoska-odgovornost-za-nestruchno-vodene-na-predmetite-vo-sudovite/?fbclid=IwAR11XLyngpzGpWra8mZM55t6_ejFvdlLac5Yp5H0NoYJdCyPuEYqCd0m_bA

7 <https://meta.mk/biznismenite-so-namalena-doverba-vo-sudstvoto/>

8 Analizë e gjykatësës së mëhershme kombëtare pranë Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburgut Mirjana Lazarova-Trajkovska, <http://respublica.edu.mk/blog/2016-02-02-14-00-51>.

9 Rastet e Gerovska - Popçevska, Ivanovski, Nikolov, Bajalxhiev, Mitrinovski, Popovski dhe Duma, Jashkovski dhe Trifonovski kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut.

10 <http://respublica.edu.mk/blog/2016-02-02-14-00-51>

2. Vendi i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev” në situatën momentale të sistemit gjyqësor dhe në procesin e ndryshimeve

Nga momenti i formimit të saj (në vitin 2006)¹¹ AGJPP-ja përfaqëson një komponentë të rëndësishme në funksionimin e gjithë sistemit gjyqësor. Ky institucion nuk mund të trajtohet si një institucion dhe strukturë e zakonshme edukative, por duhet të merret parasysh kompleksiteti dhe rëndësia që ka në sistemin gjyqësor. Në katërmbëdhjetë vitet e fundit të ekzistimit të saj, AGJPP-ja është institucioni ku detyrimisht trajnohen gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm dhe ku trajnohen në vazhdimësi gjykatësit dhe prokurorët e tanishëm.

Kjo do të thotë se kur flitet për kapacitetet e sistemit gjyqësor, për besimin e qytetarëve tek organet e gjyqësorit, për pavarësinë e gjyqësorit dhe korrupsionin në të, në të njëjtën kohë, sa i përket dekadës së fundit duhet të flitet gjithashtu edhe për suksesin e AGJPP-së në ndërtimin e kuadrove që do të kenë dituri profesionale, aftësi dhe do të jetë në gjendje që t'i kundërshtojnë çdo formë korrupsioni, ndikimi politik dhe/ose abuzim të detyrës që e kryejnë. Andaj, gjatë vlerësimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, vlerësohet në masë të madhe puna e AGJPP-së, cilësia e trajnimeve të ofruara dhe rezultati përfundimtar i tyre.

Jo rastësisht, në secilën analizë të sistemit gjyqësor si dhe në nismat e propozuara për reformë, AGJPP-ja merr një pozicion kryesor dhe paraqitet si një faktor i rëndësishëm i ndryshimit. AGJPP-ja përmendet në të gjitha dokumentet e reformës si një strukturë që ofron trajnime fillestare teorike dhe praktike për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm (si kushti i punësimit/emërimit) dhe si një strukturë që siguron trajnime të vazhdueshme në fusha specifike të përmbushjes së funksioneve të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik.

AGJPP-ja përmendet edhe në dy raportet e grupit të ekspertëve të Pribesë.¹² Në Raportin e parë përmendet se: “Kushti që vetëm të diplomuarit e AGJPP-së mund të rekrutohen në gjyqësor dhe prokurori, duhet të mbahet, për tani dhe si pasojë nuk duhet të ketë devijim, një hap prapa nga sistemi aktual i rekrutimit të bazuar në kualifikime”. Raporti i dytë i grupit të ekspertëve i vitit 2017, shumë më shumë përqëndrohet tek AGJPP-ja dhe në të theksohet se “Është realizuar vetëm njëra nga dymbëdhjetë rekomandimet nga viti 2015, në sferën e gjyqësorit dhe ndjekjes. Kjo ishte

11 Për historiatin e organizatës së AGJPP-së shih Analiza funksionale, 2019.

12 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf.

rekomandimi që AGJPP-ja të ruhet si pika e vetme për hyrje në gjyqësor, që mund të konsiderohet si mbajtje e situatës së njëjtë se sa një ndryshim”. Në raportin e grupit të ekspertëve vëmendje e madhe i është kushtuar rolit që ka AGJPP-ja, ose që do të duhej të kishte, për sa i përket “Emërimi, vlerësimi dhe promovimi të gjykatësve”.

Në shqyrtimin e Instrumentit për ndihmë teknike dhe këmbimin e informatave (TAIEX) sa i përket trajnimit të gjykatësve dhe prokurorëve publik të bërë në vitin 2018¹³ ofron një përmbledhje të dokumenteve ndërkombëtare që duhet të merren parasysh gjatë analizës së punës së AGJPP-së dhe perspektivave për zhvillimin e saj të mëtejshëm:

- Neni 10 nga Parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit të miratuar me Rezolutën 40/32 të vitit 1985, në Asamblenë e përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB- së) sipas së cilës: Personat e zgjedhur në gjyqësor duhet të jenë individ me integritet dhe aftësi, me trajnim përkatës ose kualifikime juridike.
- Parimet III-1a të Rekomandimit R (94) 12 të Komitetit të ministrave të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për pavarësinë, efektivitetin dhe rolin e gjyqtarëve: Duhet të sigurohen kushte të përshtatshme për t'i mundësuar gjykatësve të punojnë në mënyrë efektive, veçanërisht duke rekrutuar numër të mjaftueshëm të gjykatësve dhe duke siguruar trajnim të duhur si trajnim praktik në gjykata dhe kudo që është e mundur, në organe të tjera, para se të emërohen dhe gjatë gjithë karrierës së tyre.
- Kapitulli VI (Trajnimi) i Rekomandimit të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)12 i miratuar nga Komiteti i Ministrave në 2010: gjyqtarët duhet të pajisen me trajnime fillestare dhe të vazhdueshme teorike dhe praktike, të financuara plotësisht nga shteti. Intensiteti dhe kohëzgjatja e trajnimit duhet të përcaktohet në përputhje me përvojën e mëparshme profesionale.
- Neni 2.3 i Kartës Evropiane për Statutin e gjykatësve: Autoritetet do të sigurojnë që programi i trajnimit të jetë i përshtatshëm në drejtim të kërkesave të hapjes së mendjes, kompetencës dhe të jetë jopartiak që janë të lidhura me ushtrimin e detyrës gjyqësore.
- Neni 4.4 i Kartës Evropiane për Statutin e gjykatësve: Statuti ju garanton gjykatësve mirëmbajtjen dhe zgjerimin e njohurive të tyre teknike, sociale dhe kulturore, të nevojshme për të realizuar detyrat, përmes qasjes së rregullt tek trajnimet ...

¹³ TAIEX Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors in the former Yugoslav Republic of Macedonia, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Authors of the report: Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.

- Këshilli konsultues i gjykatësve evropian, Mendim nr. 4 që ka të bëjë me trajnimin përkatës fillestar dhe të vazhdueshëm.
- Nëntë parimet për trajnim gjyqësor të Rrjetit evropian të trajnimeve gjyqësore të miratuara në vitin 2016.
- Deklaratë mbi parimet e trajnimit të gjykatësve të Organizatës ndërkombëtare për trajnim të gjykatësve e vitit 2017.

Në çdo adresim të mëtutjeshëm të reformave të sistemit të drejtësisë duhet të merren parasysh këto dokumente dhe të bëhet përpjekje të zbatohen drejtpërdrejt standardet dhe procedurat e përcaktuara në procesin e funksionimit të AGJPP-së.

Sipas Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor për periudhën 2017-2022,¹⁴ angazhimet themelore strategjike për ndryshime në sektorin gjyqësor kanë për qëllim: pavarësia, paanshmëria, cilësia, përgjegjësia, efikasiteti dhe transparenca e bartësve të funksioneve gjyqësore. Secila prej këtyre udhëzimeve strategjike lidhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë me punën e AGJPP-së dhe procesin edukativ. (Vetëm si shembull, pikërisht në këtë kontekst, duhet të kuptohen edhe ndryshimet në Ligjin për gjykatat të miratuar më 4 mars të vitit 2019.¹⁵ Me këto kanë ndryshuar edhe kriteret për përzgjedhjen e gjykatësve dhe në pajtim me këto ndryshime hyrja në gjyqësor më është vetëm përmes AGJPP-së.)

Strategjia shprehet shumë qartë se “... nevojitet një vëllim në rritje i trajnimit të gjykatësve brenda AGJPP-së për të analizuar vendimet e shpallura gjyqësore që do të ishin me rëndësi për harmonizimin e praktikës gjyqësore në përputhje me standardet evropiane”. Gjithashtu përmendet se “Trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme të gjykatësve dhe prokurorëve publik në AGJPP duhet të synojnë ruajtjen e aftësive intelektuale dhe profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publik, plotësimin e tyre me njohuri dhe aftësi të reja, zotërimin e ndryshimeve në ligje si dhe çdo legjislacion të ri në fushat në të cilat ata gjykojnë dhe punojnë, duke stimuluar shkëmbimin ndërkombëtar të përvojave, duke përdorur praktikën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), të shkruarit ligjor dhe rezonimi ligjor dhe të ngjashme, me një fjalë, pengimin e plakjes së tyre profesionale”.

Gjithashtu në Strategji për sa i përket pavarësisë dhe paanshmërisë, rekomandohet: “...vendosja e kriterëve ligjorë për zgjedhjen e kandidatëve-të diplomuarve nga AGJPP-ja - nga ana e Këshillit gjyqësor dhe Këshillit të prokurorëve publik, me shpjegim të detyrueshëm dhe shpallje publike

14 <http://www.pravda.gov.mk/toc1/94>.

15 “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 96/2019.

të vendimit të përzgjedhjes; kur bëhet fjalë për cilësinë, rekomandohet të rishikohen kriteret për vlerësim të gjykatësve dhe prokurorëve publik, në mënyrë që ato të bazohen në kriterë objektive sasiore dhe posaçërisht në kriterë cilësore, me fokus në aftësitë profesionale, integritetin, ekspertizën, kompetencën personale dhe aftësitë shoqërore.” Me këtë, në fakt, jepen shumë drejtime konkrete dhe drejtohen kërkesat konkrete deri tek AGJPP-ja për të ndërmarrë aktivitete të cilat përmes procesit edukativ do të sigurojnë mu këtë cilësi të gjykatësve dhe prokurorëve publik me ta dhe njohuritë dhe aftësitë e këtilla.

3. Nevoja për ndryshime në punën e Akademisë a për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev” - analizë dhe rekomandime

Në periudhën që nga fillimi i punës së AGJPP-së dhe në veçanti duke u nisur nga rregullimi ligjor i punës së AGJPP-së (ligji i parë për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik është sjellur në vitin 2006, pas të cilit vijonte ligji i vitit 2010, pastaj ligji i vitit 2015 me të gjitha amendamentet e mëtutjeshme) e deri më sot, janë realizuar një numër i madh projektesh dhe hulumtimesh ku janë ofruar ide për organizim të trajnimeve dhe matja e cilësisë së tyre, ndër të tjera edhe përmes rezultateve të arritura dhe efektit që e kanë këto trajnime në punën dhe vendimmarjen nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve publik.¹⁶

Në analizat e kryera identifikohen problemet kryesore dhe janë dhënë rekomandime për ndryshime, për të përmirësuar arsimimin dhe hartimin e politikave të ardhme me qëllim për të rritur profesionalizmin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor. Përsëritja e konkluzave të njëjta dhe rekomandimeve shumë të ngjashme nga ana e grupeve të ndryshme të ekspertëve tregon se një numër i caktuar i këtyre ideve zbatohen rëndë, respektivisht ngelin në letër pa u operacionalizuar plotësisht dhe në mënyrë të përshtatshme në praktikë.

Gjithashtu, ekzistenca e një numri të madh të analizave dhe projekteve të përpunuara që merren me probleme identike tregon mungesën e kujtesës institucionale që do të mundësonte shfrytëzimin e plotë të njohurive të marra nga analizat dhe hulumtimet e bëra tashmë dhe një zbatim të veçantë në praktikë të modeleve teorike tashmë të vendosura.

¹⁶ Dokumenti më voluminoz është: Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703. Kjo analizë është e ndarë në më shumë segmente dhe përfaqëson një skringing gjithëpërfshirës së punës së deritanishme të AGJPP-së me drejtime të qarta për zhvillimin e mëtejshëm.

Duke pasur parasysh rekomandimet e përgjithshme në lidhje me nevojën për reforma në sistemin e drejtësisë dhe rekomandimet specifike që lidhen me organizimin dhe rolin e AGJPP-së, është e qartë se AGJPP-ja duhet domosdoshmërisht të reformohet si në aspektin e strukturës së saj ligjore ashtu edhe për proceset e brendshme, në pjesën ku ende nuk është vepruar. Qëndrimi i këtillë është i përmbajtur në Strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor (2017-2022).

Konkluzat dhe rekomandimet e deritanishme mund t'i sistemojmë në disa sfera të cilat janë në interes të kësaj analize dhe për formulimin e kahjeve për përforsim të mëtutjeshëm të AGJPP-së:

- organizim i trajnimeve
- cilësi dhe përshtatje e trajnimeve
- matja e rezultatit të arritur

Disa nga procedurat e propozuara janë transferuar në Ligj dhe akte nënligjore (veçanërisht aktet e përpunuara pas miratimit të Ligjit për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik të vitit 2015, dhe disa më herët) dhe kanë ndikuar në krijimin e procedurave dhe modeleve specifike për zhvillim të trajnimeve për të arritur një qasje më të drejtë dhe përfitim më afatgjatë nga puna e AGJPP-së mbi grupet e saja të synuara (prodhimi i materialeve arsimore, mbajtja e këtyre materialeve në AGJPP, etj.). Megjithatë, një pjesë e madhe e gjetjeve dhe rekomandimeve (veçanërisht ato që lidhen me kontrollin e cilësisë së trajnimit përmes të dhënave mbi praktikën e gjykatësve dhe prokurorëve publik dhe nivelin e zbatimit të asaj që është mësuar në punën e tyre të përditshme) nuk janë zbatuar.

Sidoqoftë, vlen të theksohet në mënyrë objektive se nëse shikohen pikëpamjet e përdoruesve të shërbimeve të AGJPP-së gjatë anketimit të bërë për qëllimet e kësaj analize në vitin 2019, (dëgjuesit nga trajnimi fillestar dhe ai i vazhdueshëm), mund të identifikohen tendencat pozitive të cilat sigurisht se lënë vend për përmirësim.

Konkretisht, dëgjuesit e deritanishëm të trajnimit fillestar e vlerësojnë cilësinë e përgjithshme të trajnimit me notë mesatare 8 (në shkallë prej 1 deri 10). Për sa i përket programit dhe lëndëve nota mesatare është 7, trajnimi praktik 8, ligjëruesit e zgjedhur kanë marrë notën 6.6, ndërsa metodologjia e ligjërimit 7. Për sa i përket vlerës praktike të trajnimit në AGJPP gjatë kryerjes së aktiviteteve punuese ditore, nota mesatare ka qenë 8.

Për sa i përket notave të marra nga grupi i shfrytëzuesve të trajnimit të vazhdueshëm, cilësia e përgjithshme e trajnimit u vlerësua në 7.8, ligjëruesit vendas me 7.5 ndërsa ata të huaj me 7.9. Katalogu i temave të

ofruara sipas të cilave zhvillohet trajnimi vlerësohet me notë mesatare prej 7.6 ndërsa vetë organizimi i trajnimit në AGJPP me notë 7.3.¹⁷

3.1. Organizimi i trajnimeve

Vlerësimet e bëra më parë për nevojat e AGJPP-së dhe udhëzimet për zhvillim të mëtejshëm janë bazuar në analizat gjithpërfshirëse të praktikave ekzistuese të cilat, sipas ekspertëve, kanë treguar se “...AGJPP-ja ka përvojë të konsiderueshme në kryerjen e Vlerësimit për nevoja të trajnimit (VNT), duke përdorur disa nga metodat më efikase (pyetësorë për vlerësim në fund të çdo ngjarjeje të trajnimit; marrje e informatave kthyesë të rregullta nga gjyqësori dhe grupet e tjera të synuara; komunikim aktiv me ligjërues, mentorë dhe pjesëmarrësit në trajnime; analiza e ideve dhe sugjerimeve nga institucione dhe organizata të tjera; njohuri të mira të procesit legjislativ)”¹⁸ Nga analizat e bëra në vitin 2010, përkundër rezultateve të anketës së vitit 2019, mund të nxirret përfundim se:

-Kur bëhet fjalë për trajnim të vazhdueshëm, kërkesa ligjore për të ndjekur një numër orësh të detyrueshme në vitin 2010 shumë shpesh ka nënkuptuar që trajnimi është organizuar dhe është përcjellur vetëm sepse ka qenë detyrimi ligjor që duhej të përmbushej e nuk është bazuar në nevoja reale. Në këtë kontekst, natyrisht, mund të shënohet edhe vërejtja në lidhje me uljen e ditëve të detyrueshme për trajnim me rritjen e kohëzgjatjes së stazhit: “Për të gjithë këta gjykatës dhe prokurorë publik, trajnimi i vazhdueshëm gjatë punës është i detyrueshëm, me atë që numri i ditëve të detyrueshme të trajnimit në nivel vjetor, zvogëlohet me rritjen e stazhit”.¹⁹ Kjo përsëri ngrit pyetjen e organizimit sasior në vend të organizimit funksional të trajnimeve, d.m.th. përmbushjes së një numri të caktuar në vend të ofrimit të trajnimit sipas nevojave. Sidoqoftë, ky konstatim ka ndikuar në përmirësimin e procedurave të kontrollit të brendshëm në kuptimin që sot 1. rregullisht vlerësohet çdo aktivitet arsimor si në kuptimin e lëndës ashtu edhe në aspekt të kënaqësisë me cilësinë e pedagogëve dhe 2. njëkohësisht kërkohen dhe të dhëna (sugjerime, reflektime) nga ana e përcjellësve të trajnimeve të vazhdueshme për tema të ardhshme që ata do t’i konsideronin si të dobishme në punën e tyre aktuale në mënyrë që të organizohen trajnime

17 Për informata më të hollësishme shih në pjesën e kërkimit empirik të bërë për nevojat e kësaj analize.

18 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 5

19 Sipas nenit 7 të “Rregullores për trajnim të vazhdueshëm”, të miratuar nga ana e Bordit drejtues të AGJPP-së për gjykatës dhe prokuror publik më 12 maj 2015 (“Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 77/2015), gjykatësit dhe prokurorët e posa emëruar kanë për obligim të realizojnë 14 ditë trajnimi në vit, përderisa, vetëm dy ditë trajnimi janë të detyrueshme për gjykatësit dhe prokurorët me përvojë profesionale prej 15 vitesh.

mu për ato tema. Këto sugjerime mblidhen, përpunohen dhe merren parasysh në intervale të caktuara kohore gjatë vitit. Tregues i kënaqësisë së përcjellësve të trajnimit të vazhdueshëm është nota e fituar mesatare prej 7.8 (në shkallë prej 1 deri në 10) për cilësinë tërësore të trajnimit të vazhdueshëm. Për sa i përket numrit minimal të ditëve për trajnim vjetor, duhet theksuar është ende në fuqi përcaktimi i shkallëzuar i ditëve, numri i të cilit zvogëlohet teksa rriten vitet e shërbimit (stazhit) të një gjykatësi/prokurori. “Mosplotësimi i numrit të nevojshëm të ditëve të trajnimit në nivel vjetor mund të sjell edhe në heqjen e pikëve respektivisht marrjen e notës më të ulët, që më vonë, mund të vështirësojë përparimin e ardhëm të gjykatësit, respektivisht prokurorit përkatës”.²⁰ Megjithatë, si krahasim, mund të theksohet se ky numër në Francë për shembull, është uniform për të gjithë, domethënë është e vënë në minimum 5, se është trajnim për secilin në nivel vjetor, pa dallim nga mosha në stazh.

- Analiza në vitin 2010 konstaton se “ka mungesë të konzistencës në metodologjitë e trajnimit dhe diskrepancë të caktuar tek stilet e ligjërimit të pedagogëve të ndryshëm në trajnimin fillestar”.²¹ Është pikërisht kjo vërejtje që lidh më tej mungesën e vazhdimësisë së duhur në ofrimin e trajnimeve. Për më tepër, sipas këtyre analizave “pedagogët nuk janë të përgatitur në mënyrë të duhur ose kompetent për të ofruar trajnimin dhe udhëheqin një diskutim profesional mbi temat specifike”.²² AGJPP-ja gjithashtu i është përgjigjur kësaj vërejtjeje duke organizuar rregullisht trajnime të trainerëve në suaza vjetore me qëllim adresimin e kësaj dobësie të perceptuar. Përpjekjet në këtë drejtim do të vazhdojnë me një ritëm intensiv. Është e kuptueshme që ky trajnim konkret nuk mund të mbulojë plotësisht ndryshimin në metodologjinë e mësimdhënies së një praktikuesi kundrejt një profesori të universitetit, për shkak të vetë natyrës së të dy profesioneve, por në këtë rast, duke pasur parasysh rolin e edukimit që realizohet në AGJPP që synon të fitojë sa më shumë përvojë praktike cilësore që do të ishte e dobishme për pjesëmarrësit në trajnim për punën e tyre të ardhshme, besohet se megjithatë, qëllimi i dëshiruar mund të arrihet. Krahas trajnimeve të trainerëve të rregullt, të plotësuar me doracak të përgatitur, në kuadër të AGJPP-së përgatiten grupe të veçanta të trajnuesve të lidhur me një sferë të caktuar ligjore, që e kanë të përshtatshme me profilet e tyre juridike (e drejta civile, e drejta penale, e drejta administrative, etj). Sipas anketës së re, cilësia e ligjëruesve nga vendi është vlerësuar me notë përmblendhëse 7.5.

20 Hornung, R., (2016), Zhvillim i planifikimit strategjik, nevojë për trajnime dhe mekanizma për vlerësim cilësor.

21 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 5

22 Ibid.

- Në vitin 2010 është marrur qëndrimi se „Nuk ka ekuilibër të mirë midis temave të ndryshme të përfshira nga programi“.²³ Në këtë drejtim, atëherë është marrë një e dhënë interesante se pjesëmarrësit në shkollë mendojnë se më shumë kohë duhet t’i kushtohet legjislacionit kombëtar në llogari të ligjit të BE-së dhe traktateve ndërkombëtare. Kjo në vetvete është problematike, duke marrë parasysh që të gjithë të pranishmit në trajnim janë avokatë me provim të kaluar të jurisprudencës, që do të thotë me njohuri të madhe të legjislacionit kombëtar, mbi bazën e të cilit ata do të duhet të ndërtojnë njohuri të reja. Nga ana tjetër, qëndrimet aktuale (2019) tregojnë se dukshëm rritet interesi për të drejtën ndërkombëtare, sidomos për Konventën evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (KEDNJ), jurisprudenca e GJEDNJ, e drejta e BE-së por edhe për dokumentet tjera ndërkombëtare të ratifikuara të cilat po bëhen pjesë e legjislacionit kombëtar. Kjo lëvizje është mjaft inkurajuese, sepse tek profesionistët e jurisprudencës rritet vetëdija për vlerat universale juridike të cilat po ndërthuren dhe zbatohen në sistemin ligjor vendor. Duhet të theksohet gjithashtu se AGJPP-ja vazhdimisht përpiket të përafrojë aktivitetet tematike arsimore që zhvillon në mënyrë të pavarur me ato që organizon së bashku me partnerë të tjerë (organizata ndërkombëtare, programe të ambasadave të huaja, organizata të shoqërisë civile, subjekte të qeverisjes vendore dhe organizata, oda etj), e tëra me qëllimin për të arritur përafrimin maksimal, përfitimin dhe efektin nga aktivitetet arsimore të realizuara. Sipas Ligjit, Këshilli programor i AGJPP-së luan një rol vendimtar në këtë çështje, por gjithashtu mund të konsiderohet edhe rekomandimi i dhënë në analizën TAIEX për krijimin e një Komiteti të përhershëm të përbashkët (AGJPP-ja në bashkëpunim me Këshillin gjyqësor, Prokurorinë speciale, gjykatat dhe prokuroritë) që do të zhvillonte një analizë më të hollësishme të nevojave për trajnim.

- Në vitin 2010, nga pikëpamja organizative e punës së AGJPP-së, ka pasur një kërkesë nga pjesëmarrësit e trajnimit fillestar për trajnim të specializuar ndaras për gjykatësit kundrejt prokurorëve publik që nga fillimi i trajnimit. AGJPP-ja aktualisht e ka rregulluar këtë çështje me një akt nënligjor që ndan trajnimin praktik për këto dy grupe të trajnuarve në trajnimin fillestar. Ndarja e gjykatësve dhe prokurorëve kryhet brenda AGJPP-së pas përfundimit të një trajnimi teorik nëntë muajsh që është i unifikuar për të gjithë. Pastaj bëhet përzgjedhja, bazuar në suksesin që kandidatët do të arrijnë në kalimin e pjesës teorike të trajnimit. Ekzistojnë dyshime nëse ky parim duhet të vazhdojë të ekzistojë, ose nëse AGJPP-ja duhet të kthehet në trajnime uniforme për të gjithë kursantët. Mendohet se pas përfundimit të një trajnimi kaq uniform, do të ishte e mundur të sigurohej prurja e personelit në dhe jashtë këtyre dy profileve profesionalë. Pyetja mbetet ende e hapur për debat pasi çdo zgjidhje sjell pasoja pozitive dhe negative.

²³ Ibid.

- Sa i përket çështjeve organizative, dhe përsëri për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve, ekziston edhe nevoja urgjente për të siguruar hapësira të reja, pra objektin e AGJPP-së. Në këtë mënyrë do të jetë në gjendje t'i përgjigjet nevojës për të fituar përvojë praktike me cilësore në procesin arsimor, si dhe të sigurojë kushte më të mira mësimi dhe pune.

3.2. Cilësi dhe përshtatje e trajnimeve

Në vitin 2010 (pesë vjet pas formimit të AGJPP-së dhe menjëherë pas sjelljes së Ligjit për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik²⁴, ka filluar projekti “Përforsimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale të AGJPP-së”, të finansuar nga ana e BE-së.²⁵

Në projekt i është kushtuar vëmendje e veçantë krijimit të sistemit për kontroll të cilësisë për programin për trajnim të vazhdueshëm.

Qëllimet e vendosura të sistemit janë:

1. Të ofrojë udhëzime rreth politikave, veprimeve dhe metodologjisë për menaxhim të arsyeshëm të Programit për trajnim të vazhdueshëm dhe zbatimit të tij.
2. Të standardizojë dhe përmirësojë procedurat dhe praktikën për krijim të trajnimit, realizim dhe vlerësim të saj.
3. Të integrojë nismat e projektit të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e informatave dhe përfshirjen e internetit në krijimin e trajnimit, realizimin dhe vlerësimin e tij.

Kompetenca e ligjëruesve dhe puna e tyre imponohet si elementi i parë gjatë realizimit të një trajnimi cilësor në numër më të madh të kërkimeve “Kompetenca përfaqëson aftësinë për të kryer detyrat me standard të caktuar....Detyra e AGJPP-së: të rritet kapaciteti për kryerjen e detyrave me standard të caktuar”.²⁶

Në kuadër të aktiviteteve është paraparë definimi i nevojave, që është hapi i parë drejt plotësimit të tyre, ku vlerësimi për VNT perceptohet si procesi i identifikimit të “boshllëqeve” në trajnim. “Kështu VNT-ja shërben për të definuar dallimin midis situatës aktuale (ku jemi) dhe asaj optimale (ku dëshirojmë të jemi)”. Është propozuar edhe një sistem i ndërlikuar i caktimit të përmbajtjes së trajnimit, përzgjedhja e ligjëruesve dhe përgatitja e tyre për të mbajtur trajnimet.²⁷

24 „Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 88/02.07.2010.

25 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 9

26 Ibid.

27 Ibid.

Në një numër rastesh (si për trajnimin bazë ashtu edhe për atë të vazhdueshëm) vërejtja është se trajnimit i mungon një sasi më e madhe trajnimesh praktike brenda së cilës do të ketë “më shumë ndërveprim; analiza lëndore dhe ushtrime praktike”²⁸. Përfundimi që trajnimi gjyqësor duhet të jetë i orientuar kah praktika, në mënyrë që të arrihet një efikasitet maksimal dhe të sigurohet një ndikim afatgjatë në punën praktike të gjykatësve dhe prokurorëve publik, është një laitmotiv i pothuajse të gjitha hulumtimeve të mëparshme.” Si konstatim kjo dhe nevoja e identifikuar shpesh paraqitet edhe në rezultatet nga anketa e fundit (2019). Sfida kryesore me të cilën është përballuar AGJPP-ja tani është fakti që shpesh mendohet se nevojat për trajnim kanë të bëjnë me të drejtën, por në fakt, sfida qëndron tek ajo që edhe nëse jemi jurist të mirë, kjo nuk duhet të thotë se do të jemi edhe gjykatës të mirë e edhe prokurorë publik të mirë”.²⁹

Deri në përfundim të ngjashëm ka arritur edhe pasqyra e trajnimit për gjykatës dhe prokurorë publik e TAIEX, e realizuar në vitin 2018³⁰, ku theksohet se “Programet për trajnim të vazhdueshëm në esencë janë teorike dhe akademike. Nuk ka shumë punëtori të vërteta për të marrë aftësi praktike. Trajnimet e ofruara nuk përkojnë me nevojat reale të gjykatësve dhe prokurorëve publik, sidomos në fillimin e karrierave të tyre”.

Nga analizat e deritanishme dhe nga vlerësimi i situatës aktuale me sistemin gjyqësor, padyshim del se trajnimet nuk duhet të vënë theksin kryesor tek të mësuarit e të drejtës materiale. Njohja e të drejtës materiale është vetëm parakusht për t’u regjistruar në AGJPP (fakultet i përfunduar dhe provim i kaluar i jurisprudencës me praktikë përkatëse). Përrjashtim nga ky qëndrim janë risitë e përfshira në ligjet, ose, aspektet e të drejtës ndërkombëtare për të cilat do të vërtetohet nevoja për ti përvetësuar ato në mënyrë plotësuese.

Trajnimi assesi nuk mund të reduktohet në mësim të përsëritur të asaj që supozohet të jetë dituri e mëparshme e kandidatëve/pjesëmarrësve në trajnim. Ajo e veçanta/specifikja që mundet dhe duhet ta ofrojë AGJPP-ja, është në fakt”...trajnim i gjykatësve dhe prokurorëve publik e cila përfshin edhe zhvillimin e aftësive dhe qëndrimeve - ndonjëherë e quajtur si arsimim mbi kontekstin social - po aq sa edhe informata për të drejtën”.³¹

28 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 5

29 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 9

30 TAIEX Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors in the former Yugoslav Republic of Macedonia, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Authors of the report: Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.

31 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 9

Megjithatë, ngel fakti që vizitorët e trajnimeve (sidomos kur bëhet fjalë për trajnimin fillestar) janë kandidatë me nivel të ndryshëm të diturisë. Për shembull, në pasqyrën për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik të TAIEX, të realizuar në vitin 2018³² është konkluduar se: “Niveli i përgjithshëm i njohurive të së drejtës në fund të studimeve universitare nuk është në nivelin e dëshiruar për pozitën e gjykatësit apo prokurorit publik, përveç nëse plotësohet me edukim dhe trajnim të mëtutjeshëm. Është e vështirë të maten kapacitetet e vizituesve që vijnë nga universitete të ndryshme”. Sipas analizës së njëjtë: “Duke pasur parasysh nivelin e ndryshëm të fakulteteve juridike në vend, notat nga universitetet nuk janë mjaft të sigurta. Provimi pranues i AGJPP-së nuk e mat mjaftueshëm aftësinë e kandidatëve për të kryer trajnimin në Akademi”. “... Duke marrë parasysh nevojën për respektim të parimit të përfaqësimit të drejtë, duhet të gjehet zgjidhje e qëndrueshme dhe e drejtë për të siguruar respektimin e këtij parimi kushtetues pa qenë i vënë në pyetje selektimi në baza meritore gjatë provimit pranues”.

Problemi i njohjes së pamjaftueshme të drejtësisë dhe veçanërisht niveli i ndryshëm i njohurive në varësi të universitetit nga i cili vjen kandidati (pavarësisht notave dhe rezultateve mesatare në letër) është një sfidë serioze për AGJPP-në e gjykatësve dhe prokurorëve publik, pasi do të duhet të punojë me kandidatë që nuk kanë gjasa për të mbajtur të njëjtin pozicion fillestar kur fillon procesin e edukimit fillestar. Kjo gjendje ndikon edhe në përgatitjen e programeve të trajnimit, baraspeshën midis njohurive teorike dhe praktike si dhe përmbushjen e angazhimit për përfaqësim të drejtë të kandidatëve nga bashkësi të ndryshme etnike. Përkatësisht, të kuptuarit e asaj që është mësuar varet nga përgatitja paraprake, aftësitë e fituara tashmë dhe njohuritë e përgjithshme në çështjet juridike.

Mënyra më e mirë për të trajtuar problemin është krijimi i një sistemi kompleks të përzgjedhjes fillestare (proces i rreptë i përzgjedhjes) me një përcaktim të qartë që jo të gjithë mund të pranohen në AGJPP, por me një porosi po aq të qartë që jo të gjithë mund ta përfundojnë këtë AGJPP. Një tjetër mundësi për të trajtuar problemin është një proces më i butë i përzgjedhjes fillestare (me pranimin e kandidatëve), megjithatë një përzgjedhje rigoroze pas modulit të parë dhe më pas pas secilit modul pasues të trajnimit. Të dy modulet duhet të ofrojnë punë të përqendruar me grupe të veçanta të studentëve për t'i ndihmuar ata të zotërojnë më lehtë një lëndë të veçantë mësimore ku do të haset në vështirësi gjatë të mësuarit.

Kjo nënkupton ose provime më të rrepta pranuese, të cilat do të siguronin që në trajnimet e AGJPP-së mund të bëhen pjesëmarrës vetëm njerëz me

32 TAIEX Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors in the former Yugoslav Republic of Macedonia, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Authors of the report: Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.

njohuri afërsisht ekuivalente të së drejtës materiale (duhet t'i kushtohet vëmendje dizajnimin ndryshe të testit elektronik), ose, nga ana tjetër, më shumë provime të njohurive si parakusht për kalimin në trajnime të mëtejshme dhe në veçanti në trajnimin praktik. Trajnimi teorik në masë të madhe është i lidhur mu me nivelin e njohurive paraprake të kandidatëve, si dhe me barazimin e këtyre njohurive. Megjithatë, në asnjë rast, trajnimi teorik nuk guxon të bëhet zëvendësues për proceset arsimore që kanë qenë më parë, përkatësisht arsimimi universitar dhe/ose për njohuritë që fitohen gjatë procesit të kalimit të provimit të jurisprudencës. Çdo rritje e trajnimit teorik dhe futja e dimensioneve të reja në të mund të nënkuptojë hyrjen në këtë grackë.

Duhet të ekzistojë një sistem adekuat rregullash dhe parimesh brenda AGJPP-së që do të sigurojë përfaqësim të barabartë të bashkësive jo-shumicë si në procesin e regjistrimit në AGJPP ashtu edhe në procesin e zgjedhjes së një karriere të ardhshme (qoftë të bëhet gjykatës apo prokuror publik), të cilat nuk duhet të reduktohen në marrëveshje joformale. Në këtë drejtim, tashmë janë bërë ndryshimet në Statutin e AGJPP-së në vitin 2019, i cili parashikon kuota për anëtarët e bashkësisë jo-shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat kuota janë caktuar duke marrë parasysh treguesit zyrtarë statistikorë.³³ Njëkohësisht, plotësimi i këtyre vendeve do të udhëhiqet sipas parimit të suksesit të arritur në notën përfundimtare të fituar, nga provimi pranues i kaluar, sidomos në kuadër të secilës kuotë të paraparë.

Rezultati përfundimtar i anketës së vitit 2010 është zhvillimi i protokolleve për secilin nga aktivitetet e parashikuara në lidhje me cilësinë e trajnimeve, por nuk ka të dhëna për atë se nëse dhe si përdoren këto protokolle. Kjo assesi nuk guxon të nënkuptojë thjeshtëzimin e trajnimeve dhe reduktimin e tyre në mjete ndihmëse për gjykatësit dhe prokurorët publik. Çdo formë e thjeshtëzimit të trajnimeve do të thotë ulje e kapaciteteve të vetë gjykatësve dhe prokurorëve publik.

Në këtë kuptim, AGJPP-ja jo vetëm që duhet të vazhdojë praktikën që në kuadër të trajnimeve të zbatojë analizën e lëndëve dhe zgjidhjen e problemeve, skenarë dhe simulime dhe diskutime në panel për të zhvilluar aftësitë profesionale, aftësitë vendimmarrëse dhe aktgjykime të bazuara në të qëniti gjykatës dhe prokurorë publik të informuar dhe me dituri, por kjo duhet ta ngritë atë në nivelin e përparësisë kryesore dhe përmbajtjes themelore të trajnimit.

Fitohet përshtypja që se në disa prej kërkimeve, përqendrimi, para së gjithash, është i fokusuar në kënaqësinë e pjesëmarrësve në trajnime me vetë trajnimet sesa në rezultatin e arritur, d.m.th. ndryshimet që këto trajnime i shkaktojnë në punën e pjesëmarrësve. Për shembull, në Rregulloren për

33 Neni 3 i Vendimit statutar për ndryshime të Statutit të AGJPP-së, 03.06.2019.

trajnim të vazhdueshëm theksohet rëndësia e vlerësimit të trajnimeve ku marrin pjesë dëgjuesit “për të përcaktuar nëse trajnimi ka arritur qëllimet e synuara, [...] nëse i ka përmbushur pritjet e pjesëmarrësve” dhe “të sigurojë një bazë për përgatitjen e programeve vijuese të trajnimit si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e trajnimeve të ardhshme”.³⁴ Megjithatë, në këtë rast duhet të arrihet baraspeshë midis kënaqësisë profesionale nga edukimi i realizuar dhe efektit real që mund të arrihet në punën e ardhshme të personit. Gjithashtu, hartimi dhe zhvillimi i programit të AGJPP-së duhet të jetë i orientuar në adresimin e problemeve të gjendjes aktuale të gjyqësorit (megjithëse është i vështirë të përcaktohet dhe i matshëm, ai megjithatë duhet të adresohet në mënyrë të tërthortë). Arsimimi duhet të përfshijë problemet aktuale dhe më globalisht, për shkak të mosbesimit ende prezent të qytetarëve në sistemin e drejtësisë (ankesat janë akoma për injorancë, partishmëri, korrupsion, sjellje joetike, etj.).

Përgjithësisht, për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe përshtatshmërinë e trajnimeve, krahas qëndrimeve të mësipërme, duhet t’i kushtohet vëmendje cilësisë së materialeve, praktikumeve dhe mjeteve të tjera mësimore; në pasurimin dhe efektivitetin e mjeteve mësimore që përdoren gjatë trajnimit; të krijohen mundësi për mësim elektronik në një larmi fushash dhe temash me interes; të monitorohet rezultati cilësor që reflektohet në zbatimin e punës së personelit gjyqësor gjatë punës së tyre.

3.3. Matja e rezultatit të arritur

Në njërin nga hulumtimet e para të bëra për qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të AGJPP-së, si pikënisje nga e cila duhet të ndërtohet i gjithë sistemi i trajnimit, është vendosur rezultati i dëshiruar. “Në vështrim të parë, është shumë e thjeshtë dhe e qartë: Filloni të krijoni pasqyrë të qartë për atë që duhet të bëjnë me sukses kandidatët (përkatesisht, rezultatin) në fund të këtij procesi të rëndësishëm edukativ. Pastaj, në bazë të kësaj pasqyre të qartë përpiloni (pra zhvilloni) programin mësimor, udhëzuesit, vlerësimin dhe përgatitjen e raporteve”.³⁵ Dhe pastaj, sipas hulumtimit të njëjtë “Bëhet fjalë për një detyrë të thjeshtë ku duhet të definohet qartë (para fillimit) se çfarë dëshirojnë kandidatët të mund të bëjnë (në fund), të mësohen se si të arrijnë këtë qëllim e pastaj të vlerësohen dhe dokumentohen rezultatet që kanë arritur”.

Nëse kjo vihet në kontekst të gjendjes së vazhdueshme dhe aktuale në sistemin gjyqësor imponohet pyetja se çfarë nuk është bërë:

34 Hornung, R., (2016), Zhvillim i planifikimit strategjik, nevojë për trajnime dhe mekanizma për vlerësim cilësor.

35 Forcimi i mëtejshëm i aftësive institucionale të AGJPP-së, IPA/2010/234-703, udhëzime për sistemin e kontrollit të cilësisë për trajnime të vazhdueshme, Shtojca 9

Përcaktimi i rezultatit përfundimtar të trajnimeve (çfarë produkti presim të fitohet në fund të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, respektivisht, a është arrirë efekti i dëshiruar)?

Në çfarë mënyre të përshtasim trajnimet në rezultatin përfundimtar që duhet/duam ta arrijmë?

Pikërsht përmes kësaj prizme duhet të shikohen aktivitetet e deritanishme (që janë në masë të madhe të propozuara edhe në kuadër të këtyre anketave) që po realizohen në AGJPP.

Për shembull, sipas rekomandimeve të dhëna në hulumtimet e mëparshme “Kontrolli i trajnimeve është paraparë të bëhet me pyetësorë standardë të vlerësimit, vlerësim të mëvonshëm (për të vlerësuar përfitimet reale të trajnimit, rëndësinë e tij të vazhdueshme dhe rezultatet afatgjata), raportet e ligjëruesve, informata kthyesë nga e drejta materiale”. Sipas këtij programi: “AGJPP-ja po zhvillon procedura dhe parametra për të përdorur informatata e marra kthyesë për të përmirësuar (a) zhvillimin e programeve, (b) vlerësimin e nevojave për trajnim, (c) cilësinë e kurrikulave të trajnimit, (d) cilësinë e trajnimeve, e) cilësinë e materialeve të trajnimit dhe f) realizimi i trajnimeve/logjistikës. Informatat kthyesë të marra do të përdoren për të përcaktuar nëse janë të nevojshme praktikat e reja të menaxhimit, nëse duhet të ndryshojë Statuti i AGJPP-së, nëse grupet e punës duhet të ndërmarrin aktivitete shtesë, etj.”³⁶ Programi parasheh: vlerësim të ligjëruesve (përmes një numri më të madh të parametrave) dhe vlerësim të materialeve që përdoren për trajnim.

Pritet që parametrat e propozuar për organizimin e trajnimeve dhe monitorimin e rezultateve të trajnimeve, që janë dhënë në materialet e deritanishme nga hulumtimet të grumbulluara, të merren parasysh drejtpërdrejt dhe të përdoren. Megjithatë, nga ana tjetër, përdorimi i njëanshëm i vetëm këtij lloji të të dhënave mund të dëmtojë efektin final që dëshirohet të arrihet, nëse realisht nuk maten njohuritë, aftësitë dhe / ose praktikat e marra dhe të zbatuara. Kësaj duhet ti shtohen dhe aftësitë menaxheriale për udhëheqjen e institucioneve gjyqësore, raporti dhe komunikimi me publikun, automatizimi dhe kompjuterizimi i veprave gjatë veprimit, shpejtësia, efikasiteti dhe efektivitet gjatë veprimit, ekonomizimi.

Në analizën e Hornung³⁷, është promovuar modeli për vlerësim Kirpatrik, i cili, sipas autorit “bazohet në katër nivele: e vlerëson cilësinë e trajnimit në nivel të reagimit fillestar, respektivisht “kënaqësisë” (Niveli 1). Por,

³⁶ Ibid.

³⁷ Hornung, R., (2016), Zhvillim i planifikimit strategjik, nevojë për trajnime dhe mekanizma për vlerësim cilësor.

gjithashtu, parasheh edhe vlerësim më afatgjatë të efekteve të qëndrueshme të trajnimit, përkatësisht i përfshin pyetjet plotësuese në vijim: çfarë është mësuar (Niveli 2 - mësimi); çfarë ka ndryshuar tek pjesëmarrësi në trajnim pas ngjarjes (Niveli 3 - ndryshim i sjelljes/përcjelljes); dhe, cili ka qenë ndikimi në trajnim mbi organizatën ku punon dëgjuesi (Niveli 4 - rezultate)”.

Nuk ka të dhëna për atë se nëse ky model është zbatuar në mënyrë të duhur dhe të plotë në vlerësimin e rezultateve nga trajnimi në AGJPP. Sidoqoftë, zbatimi i këtij modeli nënkupton zhvillimin e protokoleve të veçanta me të cilat do të sigurohet vlerësimi dhe një proces shumë më i fortë i provimit dhe një proces i monitorimit të kandidatëve në punën e tyre të mëtejshme.

Në konkluzat në pasqyrën për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publik të TAIEX, të realizuar në vitin 2018³⁸ për sa i përket trajnimit fillestar theksohet se: “Praktika e testimit të njohurive dhe aftësive përmes një provimi të ndërmjetëm dhe përfundimtar duket se nuk është e mjaftueshme për të matur aftësinë e kandidatëve për të kryer detyrat e tyre si gjykatës dhe prokurorë publik. Për më tepër, dallimi i vogël në notat e ka problematizuar radhitjen e kandidatëve...”.

Sipas nenit 34, nga Rregullorja për trajnim të vazhdueshëm “Duke marrë parasysh karakterin e trajnimit, respektivisht ciklin e trajnimeve, ligjëruesit e përcaktojnë llojin dhe metodologjinë e kontrollit, që mund të jetë në formën e dhënies së pyetësorëve dhe/ose testeve me përmbajtjen e ligjëratave dhe materialeve të ekspozuara menjëherë pas mbarimit të trajnimit dhe/ose në formë të notës të nivelit të përmirësimit të njohurive, aftësive, sjelljes si dhe zbatim i asaj që është mësuar në praktikë, në periudhë të caktuar kohore pas mbarimit të trajnimit ose ciklit të trajnimeve (3, 6 ose 12 muaj)”.³⁹

Kjo në masë të madhe kufizon mundësitë e AGJPP-së, përkatësisht vlerësimi i përgjithshëm është vënë në duart e ligjëruesit. Megjithatë, në raportin e përmendur të Hornung⁴⁰ theksohet se “Trajnimi i vazhdueshëm i gjykatësve dhe prokurorëve me cilësi të mirë dhe të qëndrueshme duhet të jetë i përfshirë në konceptin e “trajnimit gjatë gjithë jetës” si dhe në konceptin e plotësimit periodik të suksesit të secilit gjykatës dhe prokuror veçmas”. Kjo nënkupton nevojën për të zhvilluar më tej sistemin e rishikimit të vazhdueshëm që do të lejojë vlerësimin e saktë të rezultateve të trajnimit. Për më tepër, sipas këtij raporti të ekspertit “Duke pasur parasysh faktorët e përmendur më lart, do të ishte e gabuar të thuhet që

38 TAIEX Peer Review on Judicial Training for Judges and Prosecutors in the former Yugoslav Republic of Macedonia, Mission timeframe: from 23/04/2018 to 26/04/2018, Authors of the report: Judge Lennart Johansson and Judge Dragomir Yordanov.

39 “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 77/2015.

40 Hornung, R., (2016), Zhvillim i planifikimit strategjik, nevojë për trajnime dhe mekanizma për vlerësim cilësor.

një numër i caktuar ditësh trajnimi në një periudhë të caktuar kohore është gjithmonë një kriter i vlefshëm dhe i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së gjykatësit/prokurorit përkatës, vetëm pjesëmarrja në trajnime vetëvetiu nuk garanton të mësuarit si dhe ndryshimin në sjellje dhe ndryshime institucionale”.

Në vend të ashpërsimit të kriterëve gjatë kalimit të provimeve pranuese, të mesme dhe të fundit, me ndryshimet në Rregulloren për trajnim fillestar nga viti 2017 dhe 2018 janë bërë lehtësime në kontrollin e njohurive (duke shpallur një bazë pyetjesh, përgjigje të ofrurara me një përgjigje të saktë dhe dy të pasakta dhe mungesa e pikave negative për përgjigje të gabuar. Këto ndryshime janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me konkluzat dhe rekomandimet e dhëna në të gjitha analizat dhe vlerësimet e deritanishme të ekspertëve për punën e AGJPP-së.

Nevoja për një qasje të ndryshme në testimin e njohurive të kandidatëve në AGJPP është identifikuar edhe në Analizën e zbatimit të prioritetëve të reformës urgjente në gjyqësorin maqedonas⁴¹. Sipas autorëve të kësaj analize “Në pjesën e trajnimit fillestar nevojitet të ndërpritet kalimi i provimit në mënyrë elektronike të pjesës praktike të provimeve. Për më tepër, janë të nevojshme më shumë ushtrime praktike dhe simulim gjykimesh”.

Një element i rëndësishëm në përmirësimin e trajnimit (që përmendet në disa nga studimet e mëparshme) është individualizimi më i madh i mundshëm i trajnimit. Në vetë analizat nuk janë dhënë kriteret specifike mbi bazën e të cilave qasja në trajnim do të individualizohet, por theksohet si një mënyrë për të siguruar një pasqyrë më të mirë tek ndryshimet individuale të secilit kandidat pas mbarimit të testimit përfundimtar.

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale dhe të vazhdueshme në sistemin gjyqësor, cilësia e trajnimeve dhe përparimi i kandidatëve duhet shumë më pak të matet përmes procesit të vetëvlerësimit nga ana e kandidatëve, ndërsa vëmendje shumë më të madhe duhet ti kushtohet testeve/provimeve ose llojeve të tjera të kontrollit të progresit nga ana e ligjëruesve.

Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të balancohen parametrat sasiorë dhe cilësor të vlerësimit, të cilat do të mundësojnë vlerësimin faktik të suksesit të trajnimeve dhe do të bëjnë më të dukshëm ndryshimin e mundshëm si rezultat i trajnimeve. Kjo është edhe njëra nga rekomandimet që e ka dhënë Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GREKO) në Këshillin e Evropës në Raportin e 17 marsit, 2014 në kuadër të rrethit të IV të vlerësimit për “Parandalim i korrupsionit tek deputetët e kuvendit, gjykatësit dhe prokurorët”: “...sa i përket parimit të pavarësisë gjyqësore, sistemi për

⁴¹ Petrovski, K., Draganov, M., ..., (2018), “Analiza e zbatimit të prioritetëve urgjente të reformave në gjyqësorin maqedonas”, Instituti i të Drejtave të Njeriut, Shkup.

vlerësimin e performancës së gjyqtarëve [...] duhet të konsiderohet për futjen e kriterëve më cilësore.”⁴²

4. Zgjidhje të reja ligjore

Për momentin, Propozim-ligji për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik gjindet në procedurë parlamentare.⁴³ Një pjesë e rekomandimeve të deritanishme (të përfshira në analizë, veçanërisht analizën TAIEK si dhe mendimet e ekspertëve të dhënë) janë transferuar në dispozita në propozimligjin e ri për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik.⁴⁴

Praktikisht, AGJPP-ja mbetet institucioni i vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut që në mënyrë të tërthortë- përmes pranimit - vendos se kush në të ardhmen do të bëhet gjykatës ose prokuror publik në shtet. Me këtë, ajo zë një vend të rëndësishëm në gjyqësor. Gjithashtu, siç është theksuar në disa raste, trajnimet, veçanërisht ato fillestare, janë veprimtaria kryesore e AGJPP-së.

Përveç serisë së risive në organizimin e AGJPP-së, ka edhe ndryshime në kushtet që duhet t'i përmbushin kandidatët për pranim në trajnimin fillestar në AGJPP. Sipas Analizës për zbatim të strategjisë për reformimin e sektorit gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018 dhe 2019, bërë nga Grupi Blueprint për reforma në gjyqësor⁴⁵ “Pjesa më e madhe e risive kanë të bëjnë me kalimin e provimit pranues dhe përfundimtar në AGJPP si dhe kalimin e secilit nga modulet në fazën e parë të trajnimit fillestar. Mënyrat e reja për të dhënë provimet janë më të përshtatshme dhe më të thjeshtëzuara për të matur dituritë”. Për dallim nga zgjidhja e mëparshme (e rregulluar me Ligjin nga viti 2015, (e cila u shfuqizua nga ndryshimet e vitit 2018) i cili kërkonte një mesatare të notës më të lartë nga studimi në fakultet, sipas propozimit të ri, si kandidat për trajnim fillestar mund të pranohet një jurist i diplomuar me arsim të lartë katërvjeçar VII/I nivel i studimeve të drejtësisë ose jurist i diplomuar me 300 kredite të fituara sipas Sistemit evropian të transferimit të kredisë.

Në këtë mënyrë, ligjvënësi ka vendosur të mundësojë një numër më të madh të kandidatëve të aplikojnë për trajnimin fillestar në AGJPP, në

42 Faqja 29 nga Raporti, i shpallur në www.coe.int/Greco.

43 <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

44 <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=c904f559-5ef8-4328-9120-7205a0621309>.

45 Avramovski, D., Amet, S., ... (2018), Analiza e zbatimit të të strategjisë për reformë në sektorin gjyqësor (2017-2022) për periudhën nga viti 2018/2019, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shkup.

veçanti avokatët me përvojë dhe praktikë më të gjatë, të cilët nuk kanë pasur mesatare më të lartë gjatë studimit. Në të njëjtën kohë, përzgjedhja e kandidatëve bëhet përmes një provimi pranues shumëfazor, i cili kontrollon plotësisht njohurinë dhe gatishmërinë e plotë të kandidatit: njohjen teorike, praktike të gjuhës dhe testim psikologjik.

Autorët e kësaj analize dallohen në qëndrimin e tyre në lidhje me dizajnin e pjesës (kualifikuese) për pranim të provimit. Megjithatë propozim ligji i ri thjeshton hartimin e pyetjeve (pesë modalitetet e përshkruara komplekse-përgjigjet e pyetjes tani janë reduktuar në tre); pikë minimale për të kaluar që ishte 41 tani është ngritur në minimum 76 - nga gjithsej 100) dhe e rrit kushtin eliminues për kalim, megjithatë, ekziston ndryshim i qartë në mendimet: njëri autor i tekstit mendon se, në përgjithësi, në provim nuk duhet të ketë pyetje të cilat jepen në kompjutor, përdërisa tjetri mendon se me dizajnin e këtyre të ndryshuar në dukje të pjesës kualifikuese të provimit mund të arrihet tek eliminimi fillestar i kandidatëve më të dobët. Pjesa praktike e provimit propozohet të zhvillohet me shkrim, me përgatitjen e dy studimeve të rastit (35 pikë në përgjithësi), ndërsa në fund, në pjesën e provimit me gojë ndahen një numër më i madh i pikëve (35 pikë gjithsej) në krahasim me zgjidhjen e mëparshme ligjore.

Trajnimit praktik përforcohet duke rivendosur simulimin e gjykimit si një mjet vlerësimi, veçanërisht si pjesë e provimit përfundimtar.

Çështja e përfaqësimit të drejtë të bashkësive është e mbuluar nga një dispozitë e përgjithshme në ligj, dhe aktualisht është rregulluar si pjesë e Statutit, i cili shtjellon atë dispozitë ligjore për përfaqësim të drejtë. Kërkesa minimale fillestare që i takon një bashkësie jo-shumicë të konsiderohet si kandidat është fillimisht të fitojë të paktën pikët minimale të kërkuara me ligj për të kaluar pjesën kualifikuese dhe praktike të provimit dhe të kalojë provimin e gjuhës, testin psikologjik dhe atë të integritetit. Pastaj, numri i vendeve të caktuara sipas kuotës plotësohen sipas lartësisë së rradhitjes, përkatësisht numri i fituar maksimal i pikëve nga pjesa kualifikuese dhe praktike nga provimi i një kandidati.

Neni problematik nga aspekti i diskriminimit të mundshëm (sidomos për personat me aftësi të kufizuara) për çka duhet të kihet kujdes me nenin 31, ku tek kushtet për fillim të trajnimit fillestar është paraparë “aftësia e përgjithshme shëndetësore”. Ekziston nevoja që dispozita të rregullohet në formë të qartë që të pamundësojë diskriminim potencial për sa i përket pranimit të personave të cilët do të mund të kryenin punën e tyre edhe krahas aftësive të kufizuara.

Mosbalancimi në favor të trajnimit praktik është në përputhje me rekomandimet e dhëna në pjesën më të madhe të analizave të bëra, por është jashtëzakonisht e rëndësishme edhe pjesa teorike të mos jetë një

përsëritje e përmbytjes së fakultetit, por një pëditësim që synon ushtrimin e funksionit të gjykatësit ose të prokurorit publik.

Mundësia për përsëritje të testimit, përderisa është i pasuksesshëm (e dhënë në nenin 52) nuk është e precizuar dhe mund të çojë drejt zvogëlimit të cilësisë të rezultatit përfundimtar (që është në kundërshtim të rekomandimeve të dhëna në shumicën e analizave).

Në pajtim me rekomandimet e TAIEX, rekomandohet program i veçantë i specializuar për gjykatësit dhe prokurorët e posazgjedhur, me qëllim që të arrihet adaptimi i tyre më i shpejtë dhe gjindshmëria në detyrat e reja të punës. Programi i përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm në pjesën më të madhe jepet për tu rregulluar me aktin e AGJPP-së.

Mendime përmbyllëse

Në periudhën nga themelimi i AGJPP-së dhe sidomos që nga miratimi i ligjit të parë për Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publik e deri më sot, janë bërë një numër i madh analizash, kërkimesh dhe mendime ekspertësh, në kuadër të të cilave janë identifikuar problemet me të cilat po ballafaqohet AGJPP-ja dhe janë dhënë drejtime për zhvillimin e mundshëm të mëtejshëm dhe rekomandime për funksionim më të mirë.

Zgjidhjet e reja ligjore ofrojnë bazë të mirë që një pjesë e madhe e këtyre rekomandimeve të jenë të strukturuar në mënyrë normative dhe të krijohet hapësirë për zbatimin e tyre në praktikë. Pas sjelljes së Ligjit të ri, AGJPP-ja do të sjell dhe aktet nënligjore të reja, në të cilat do të plotësojë procedurat dhe mekanizmat ekzistues për plotësim dhe precizim të mëtejshëm të dispozitave ligjore, por edhe për vendosjen e rregullave të brendshme të punës.

Njëra nga sfidat kresore me të cilat ballafaqohet AGJPP-ja (sipas rekomandimeve të përmbledhura të dhëna në analizat dhe hulumtimet e bëra) është fakti që shpesh mendohet se nevoja për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve të rinj ka të bëjë vetëm me të drejtën, ku harrohet funksioni i ndërlikuar i një gjykatësi/prokurori publik i cili nënkupton edhe aftësi dhe përgatitje më të gjerë të nevojshme shoqërore si dhe karakteristikat dhe cilësitë specifike të njeriut që e kryen. Gjegjësisht, një avokat i mirë nuk do të thotë që mund të jetë edhe gjykatës ose prokuror publik i mirë.

AGJPP-ja profillohet si hyrja e vetme në kryerjen e funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, që nënkupton edhe përgjegjësi të veçantë për rezultatin nga trajnimet që realizon. Kjo do të thotë edhe qëndrim i qartë se jo secili mund të vijojë këto trajnime (vendosja e kriterëve shumë të

larta për pranim), por për më tepër, se jo secili që ka kaluar trajnimin do të thotë që edhe të përfundojë atë (kritere edhe më të larta për provimin përfundimtar dhe kontroll të diturisë dhe aftësive të kandidatëve). Një aspekt shumë më i rëndësishëm për vlerësimin e trajnimeve nga ana e vetë pjesëmarrësve, që është një vlerësim shumë-disiplinor, i vazhdueshëm dhe rigoroz i kandidatëve gjatë kohëzgjatjes së trajnimit.

Trajnimi praktik edhe shumë më shumë, pjesa praktike e provimit, duhet të jenë dukshëm dominuese. Mënyra më e mirë për të vërtetuar si diturinë (diturinë juridike), ashtu edhe të gjithë komponentët tjerë që nevojiten për kryerjen e funksionit (sociale, psikologjike, logjike, çështja e elokuencës, raporti ndaj diverzitetit dhe ngjashëm) është kalimi i provimeve përmes simulimit të gjyqimeve (raste të ndërlikuara dhe të shumëfishta ku janë dhe parametrat për vlerësim).

Rangimi duhet të tregojë dallimet e vërteta/reale midis kandidatëve dhe nuk do të thotë vetëm mundësi për përzgjedhje të funksionit të gjykatësit ose prokurorit publik, por të jetë pjesë edhe çdo përparim i mëtejshëm në karrierë i kandidatëve.

Individualizimi i trajnimeve është i rëndësishëm së veçantë (si në aspekt të dallimeve midis gjykatësve dhe prokurorëve publik, ashtu edhe në aspekt të specializimit të mundur të kandidatëve në të ardhmen, fusha në të cilën do të punojnë dhe mjedisi në të cilin duhet të funksionojnë).

Trajnimi i vazhdueshëm duhet të perceptohet si pjesë e përparimit dhe zhvillimit në karrierë i secilit gjykatës dhe prokuror publik. Ai duhet të jetë i detyrueshëm në çdo shkallë të përparimit të gjykatësve dhe prokurorëve publik dhe të përkojë me kërkesat e funksionit më të lartë kah i cili synon.

Trajnimi i vazhdueshëm duhet të adresojë problemet e identifikuara veç më që lindin si në vlerësimin e gjyqësorit nga ana e publikut ashtu edhe në analizat e ekspertëve të profesionit. Në trajnime, duhet të gjindet vend edhe për temat më të “buta”, si problemet e diskriminimit, të trajtimit të pabarabartë, respektimi i dinjitetit të palëve, menaxhimi i institucioneve të gjyqësorit, raporti drejt opinionit dhe transparenca, pavarësia nga ndikimet partiake, etika dhe logjika etj.

Duhet pasur kujdes për përfaqësimin e drejtë të bashkësive jo-shumicë pa ndikuar në cilësinë e gjykatësve dhe prokurorëve publik që dalin nga AGJPP-ja. Nevoja nga një numër i përfaqësuesve nga bashkësia konkrete etnike apo gjuhësore, asesi nuk guxon të jetë në dëm të cilësisë, por të realizohet përmes stimulimit të kandidatëve të mundshëm, nëse është nevoja edhe punë plotësuese, përmes numrit më të madh të njësive arsimore. Rezultati përfundimtar assesi nuk guxon të jetë në dëm të cilitdo nga qëllimet e synuara të trajnimit.

Nevoja për numër të caktuar të gjykatësve ose prokurorëve publik duhet të formulohet në bazë të të dhënave reale, kalkulimeve statistikore, nevojës së shprehur dhe planifikimit afatgjatë. Kjo nënkupton edhe përfshirjen e elementit për përfaqësim të drejtë dhe të duhur të bashkësive jo-shumicë.

Hulumtimi empirik i Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”

Me qëllim që të fitohet një pasqyrë më e qartë për perceptimit e profesionistëve nga gjyqësori të cilët janë në role të ndryshme dhe nga aspekte të ndryshme të involvuar në punën e AGJPP-së, një pjesë e kësaj analize i kushtohet marrjes së njohurive për pikëpamjet e tyre. Këto njohuri të përmbledhura janë veçanërisht të rëndësishme për të marrë një pamje reale të punës së AGJPP-së dhe shkallën e plotësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre profesionale në fushën e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm, por edhe për sa i përket vendosjes sistematike dhe rolit të këtij institucioni.

Janë realizuar tre anketa të veçanta të cilat kishin për synim tre grupe të të anketuarve edhe atë: dëgjues (të tanishëm dhe të mëparshëm) në trajnimin fillestar në AGJPP; pjesëmarrësit në trajnimin e vazhdueshëm në AGJPP dhe përfaqësues, përkatësisht anëtarë të trupave dhe institucioneve puna e të cilave është e lidhur me AGJPP-në (Këshilli gjyqësor, Këshilli i prokurorëve publik dhe ngjashëm). Pyetjet e anketave përmbanin modalitete të mbyllura në përgjigjet, por edhe një pjesë në të cilën të anketuarit kishin mundësinë për të përmendur sygjerimet, mendimet dhe kritikën e tyre lirshëm, të cilat janë të përmendura në mënyrë të përmbledhur në këtë analizë.

Vijojnë rezultatet e përmbledhura nga secila anketë e realizuar, të cilat janë përpunuar në mënyrë statistikore në pjesën e pyetjeve me modalitete të mbyllura në përgjigjet, ndërsa pyetjet e hapura të cilat paraqiten më shpesh në përgjigjet e dhëna tekstualisht, përkatësisht shfaqin rëndësinë, ato janë gjithashtu të përmbledhura.

A. Pasqyrë e rezultateve të marra nga dëgjuesit në trajnimin fillestar të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”

Në pyetësor janë përfshirë 53 dëgjues aktual dhe të mëparshëm të trajnimit fillestar në AGJPP. Vijojnë përgjigjet e tyre për një grup pyetjesh që kanë të bëjnë me kënaqësinë nga puna dhe cilësia e programit të AGJPP-së. Për sa i përket profilit demografik të këtij grupi të të anketuarve, duke

marrë parasysh ndjekjen e vazhdueshme të realizimit të anketës nga ana e shërbimeve në AGJPP të cilët e realizonin pjesën empirike⁴⁶, mund të konkludohet se është arritur barspeshë, për sa i përket raportit të përfaqësimit sipas gjinisë (49%-51%) dhe duke marrë parasysh se AGJPP-ja ka filluar me punë në vitin 2006, diapazoni i të gjithë të anketuarve varion nga 30 në 49 vjeç.

1. Struktura demografike e të anketuarve sipas gjinisë

Gjinia	
Femërore	51%
Meshkuj	49%

2. Struktura demografike e të anketuarve sipas kategorive të moshës

Moshë	
18-29	0,5% (1)
30-49	99,5% (52)

Pyetja për pozitën momentale të punës e të anketuarve është lënë e hapur, ndërsa përgjigjet për të njëjtën pyetje janë grupuar në mënyrë plotësuese, kështu AGJPP-ja, respektivisht dëgjues në trajnimin fillestar janë përgjigjur 9 të anketuar, prokuror publik janë përgjigjur 8, kandidatë (për prokuror publik/gjykatës) 4, përderisa, gjykatës 9 të anketuar. Të 23 të intervistuarit nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Shpërndarja e përgjigjeve në këtë pyetje për shkak të momentit në të cilin u zhvillua hulumtimi, pasi aktualisht po përfundonte trajnimi i Gjeneratës së gjashtë të dëgjuesve në AGJPP, e cila akoma kishte statusin e dëgjuesit, pra kandidatit për gjykatës/prokuror të ardhshëm. Personat e tjerë të anketuar të cilët veç më janë të zgjedhur dhe punojnë në pozitën e gjykatësit ose prokurorit dhe u takojnë gjeneratave të mëhershme të cilët veç më kanë mbaruar edukimin e tyre.

46 Të dhënat e mbledhura elektronike evidentojnë se në raport për sa i përket të dhënave demografike të përgjithshme, më shumë se 40% e të anketuarve nuk janë përgjigjur, gjë që nuk jep një pasqyrë të qartë të mostrës, por në të njëjtën kohë nuk lejon të merren të dhëna më të hollësishme për kategoritë e tjera duke bërë pyetje të tërthora. Për sa i përket gjinisë, nëse shihet në numri absolut, këtij pyetësori i janë përgjigjur 15 gra, 13 burra, ndërsa 5 të anketuarit tjerë kanë refuzuar të përgjigjen ose nuk ka të dhëna për ta. Për sa i përket kategorisë së moshës, të anketuarit të cilët janë përgjegjur në këtë pyetje, kryesisht i takojnë kategorisë prej 30-49 vjet (29 të intervistuar), ndërsa vetëm një është i regjistruar në kategorinë deri në 29 vjeç, 23 të anketuarit tjerë nuk janë përgjegjur në këtë pyetje. Megjithatë, menaxhimi me pjesën empirike të hulumtimit është në pozitë të kapë profilin statistikor të këtij grupi të anketuar

3. Struktura e të anketuarve sipas pozitës së punës dhe institucionit


Pozita e punës dhe institucioni	
AGJPP-së, dëgjues në trajnim fillestar	9
Prokuror publik	8
Kandidat	4
Gjykatës	9
Pa përgjigje	23

Vlerësim i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurosë Publikë

Në fillim, të anketuarit ishin të pyetur se si e vlerësojnë nevojën për ekzistim të AGJPP-së. Nga përgjigjet e marra nga dëgjuesit e trajnimit fillestar mund të shihet se ekziston pajtim i plotë për nevojën për ekzistim të këtij institucioni. 60% nga ta konsiderojnë se e njëjta është dashur të hapet që moti, ndërsa 40% nga ta mendojnë se është hapur me kohë. Asnjë nga të anketuarit në trajnimin fillestar nuk është shprehur negativisht rreth ekzistimit të AGJPP-së, pra se nuk e konsideron atë si të panevojshme (grafiku nr. 1).

Grafikon 1.

Si e vlerësoni nevojën e ekzistimit të AGJPP-së?



Si plotësim ndaj kësaj pyetjeje është lënë hapësirë për koment, përmes së cilës gjysma e të intervistuarve kanë shprehur vështrimin e tyre në lidhje me nevojën e ekzistimit të AGJPP-së. Përgjigjet e dhëna në masë dominuese janë afirmative dhe pozitive - “AGJPP-ja është absolutisht e nevojshme dhe e ka arsyetuar ekzistimin e saj”. Konsiderohet se AGJPP-së është përgjigje e shkëlqyer institucionale e gjendjeve të mëparshme kur janë zgjedhur gjykatës pa asnjë ditë të kaluar në gjykata ose ndonjë edukim tjetër përkatës.

Në komentet tjera të dhëna, është përmendur se “AGJPP-ja duhet të ekzistojë edhe për shkak se: të gjithë kandidatëve të cilët nuk kanë pasur mundësi të përfshihen në organet e gjyqësorit u jepet mundësia që këto njohuri ti marrin përmes AGJPP-së; vetë trajnimi ju mundëson kandidatëve të

dëgjojnë ligjërata nga ligjërues që flasin nga pozita të ndryshme - gjykatës, prokurorë publik, profesorë universitar, avokatë dhe ngjashëm, me çka, vetë kandidatit nga disa kënde i mundësohet analiza dhe interpretimi i të drejtës dhe parimeve të së drejtës dhe ndarja e përvojave praktike nga puna e tyre”.


Kështu, pjesëmarrësit në trajnimin e deritanishëm fillestar thonë se është jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe në drejtim të procesit reformues, për shkak se zgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm kryhet vetëm përmes këtij institucioni nga rradhët e kandidatëve për trajnim fillestar edhe atë përmes një procesi të ndërlikuar të testimit pranues që pritet të eliminojë ndikimet partiako-politike ose të tjera gjatë përzgjedhjes së dëgjuesve të ardhshëm. Kjo ndjenjë e pavarësisë profesionale mbahet edhe më tutje gjatë kohëzgjatjes së trajnimit, për shkak se dëgjuesit e zgjedhur kanë ndjenjën e pavarësisë të mëtejshme të pamohueshme, duke e ditur që nuk varen nga ndonjë proces politik ose nga vullneti i individëve që do të zgjidhen si gjykatës ose prokurorë kur të përfundojnë procesin e edukimit në AGJPP.

Në përgjigjet, përvihet gjithashtu edhe angazhimi i AGJPP-së përmes programit të saj arsimor të garantojë prodhimin e kuadrove profesionale, të pavarura, të paanshme dhe cilësore. Për sa i përket trajnimit që merret në AGJPP, përmendet se mundësohet përgatitje gjithpërfshirëse për gjykatësit dhe prokurorët publik të ardhshëm si dhe shkëmbimi i mendimeve dhe përvojave tek gjykatësit dhe prokurorët publik të tanishëm, por edhe të profesionalizimit të mëtejshëm.

Në drejtim të cilësisë së përgjithshme dhe tërësishme të trajnimit të anketuarit kanë dhënë notat si në vijim: 20% nota 9; 24% nota 8; 18% nota 7; 6% nota 6; 3% nota 5; a 6% nga të anketuarit kanë dhënë notën 4. (grafiku nr. 2) Nota mesatare e cilësisë së përgjithshme të trajnimit është 8, që do të thotë se dëgjuesit e AGJPP-së e kanë vlerësuar atë lartë.

Grafikoni 2.

Vlerësoni kualitetin e përgjithshëm dhe të plotë të trajnimit të cilin e kishit/ keni në AGJPP?



Pjesëmarrësit në trajnimin fillestar konsiderojnë se përmes trajnimit kanë qasje të veçantë deri tek të gjitha situatat e mundshme të cilat i presin gjatë punës së tyre si gjykatës dhe prokuror publik. Ata konsiderojnë se përmes intensivitetit të ligjërimeve bëhet fokusimi i vërtetë i profesionit të ardhshëm; është pozitive që diapazoni i sferave për të cilat realizohet edukimi është shumë i gjërë; cilësia e tyre kadrovike përmirësohet dukshëm sepse kanë qasje deri tek ligjëruesit me përvojë të cilët mund të përgjigjen edhe në pyetjet më të ndërlikuara dhe dilemat profesionale; mësimi praktik ka mundësuar që kandidatët të fitojnë njohuri të cilën nuk do ta kishin marrë ndryshe; është pozitive që edukimi përfshin edhe etikën dhe përgjegjësinë profesionale. E shikuar në përgjithësi, për sa i përket programit për trajnim, konsiderohet se është më mirë i strukturuar dhe i balansuar, por megjithatë, kërkohet më tepër praktikë edukative dhe më pak teori.


Dëgjuesit në AGJPP konsiderojnë se kushtet për pranim në trajnimin fillestar duhet të jenë më rigorozë, respektivisht përsëri të kërkohet mesatare më e lartë gjatë studimeve si në periudhën e mëparshme (koment që e kanë përmendur disa të anketuar), por edhe të kërkohet nivel i njohurisë së gjuhës së huaj në minimum nivel B2⁴⁷.

Në tabelat e prezantuara më poshtë janë treguar përqindjet nga notat të cilat i kanë dhënë të anketuarit, në shkallë prej 1 deri në 10, në drejtim të disa aspekteve në lidhje me punën dhe programin e AGJPP-së edhe atë: Programi dhe lëndët në AGJPP, Ligjëruesit e zgjedhur, Metodologjia e ligjërimit, Trajnimi praktik, Cilësia e shërbimeve lidhur me administrimin në AGJPP dhe Sistemi i punës me mentor gjatë trajnimit praktik. Si mundësi plotësuese për të shprehur përshtypjen e tyre për secilën nga kategoritë e përmendura, nën çdo pyetje është lënë edhe mundësi për koment.

Për programet dhe lëndët në AGJPP, 19% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 11% kanë dhënë notën 9; 23% me notë 8; 9% me notë 7; 8% me notë 6; 19% me notë 5; 6% me notë 4; 2% me notë 3 dhe 4% me notë 2 (grafiku 3). Vlera mesatare për pyetjet në lidhje me këtë pyetje është 7.

⁴⁷ <https://www.coe.int/en/web/common-european-framework-reference-languages>

Grafikoni 3.
Vlerësoni katalogun e trajnimeve të AGJPP-së



Komentet në lidhje me këtë pyetje në pjesën më të madhe përbëhen nga nota pozitive për programin dhe shtrirjen e lëndëve të cilat janë pjesë e programit mësimor dhe se përkojnë me grupin qëllimor për të cilin janë të destinuara.

Vërejtjet e përmendura kanë të bëjnë me propozimin që lëndë të caktuara të dëgohen pa u bërë kontrolli i diturisë⁴⁸ pasi që janë dytësore ose nëfunksion të kulturës së përgjithshme të dëgjuesve. Është kërkuar që trajnimi teorik të përmbajë më pak teori dhe ti kushtohet më shumë vëmendje lëndëve kryesore. Nga ana tjetër, është sygjieruar që të futen më shumë simulime të gjykimeve që nga pjesa teorike, si dhe gjatë edukimit të theksohen më shumë ligjet procedurale (Ligji për procedurën penale (LPP), Ligji për procedurën civile).

Një çështje e veçantë është hartimi i trajnimit sipas profilit që kandidati do të ketë pas përfundimit të trajnimit fillestar. Aktualisht, kjo pyetje rregullohet nga një akt nënligjor i AGJPP-së, e cila përcakton pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit, në varësi të suksesit të provimit dhe mundësisë për zgjedhje, kandidatët ndahen në dy grupe - një grup gjykatës dhe një grup prokurorësh - të cilët më pas ndryshojnë në trajnimin e tyre praktik që vijon. Në komentet e disa të anketuarve, është përmendur se programi nuk është i përshtatshëm, dmth ka tre module, të cilat realisht nuk u nevojiten kandidatëve të cilët marrin vendim për prokuror publik, sepse dëgjojnë të drejtën civile dhe administrative, që asnjëherë nuk do t’ju duhet. Nëse një ndarje e tillë vazhdon, sugjerohet që nga fillimi programi dhe lëndët të përshtaten me profesionin e tyre të ardhshëm, në mënyrë që efekti i trajnimit të ofruar të jetë shumë më efikas.


48 Në lidhje me informatikën dhe kërkimet juridike, mjekësi ligjore, psikiatria ligjore, psikologjia ligjore, etika, retorika, aftësi komunikimi, gjuha angleze.

Është shprehur angazhimi që programi dhe lëndët të jenë të barazuara dhe sistematizuara e temat të mos përsëriten shumë herë. Po ashtu, trajnimi duhet të jetë më mirë i dizajnuar dhe mos të varet vetëm nga përpjekjet dhe zgjuarsia e pedagogëve dhe mentorëve individual, pasi ka pasur lëndë ku me të vërtetë është fituar dituri cilësore dhe lëndë ku nuk është mësuar asgjë (të bëhet revizion i ligjëruesve). Të furnizohen me materiale më të reja dhe më cilësore (për BE-në dhe të drejtën ndërkombëtare).

Për ligjëruesit në AGJPP-së, 11% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 6% kanë dhënë notën 9; 17% me notë 8; 21% me notë 7; 17% me notë 6; 11% me notë 5; 11% me notë 4; 4% me notë 3 dhe 2% me notë 2 (grafiku nr. 4). Që të mund të vlerësohet më lehtë se si kandidatët i vlerësojnë ligjëruesit, është përlogaritur vlera mesatare dhe e njëjta është 6,6.

Grafikoni 4.

Në shkallën nga 1 deri në 10 i vlerësoni prezantuesit e përzgjedhur nga AGJPP-ja



Sa i përket ligjëruesve të përzgjedhur në përgjithësi është shprehur kënaqësia nga cilësia e tyre. Është përmendur se “ligjëruesit janë përpjekur për të dhënë njohuritë dhe përvojën e tyre në fushën e tyre, ata kanë qenë të përgatitur për ligjëratat dhe për t’u përgjigjur të gjitha pyetjeve” dhe se ishin profesionistë dhe entuziastë të mirëfilltë që e justifikuan shumë angazhimin e tyre.


Vërejtjet e cituara përmendën vështirësinë e disa pedagogëve në mënyrë të shkathtë të planifikojnë metodologjikisht qasjen e tyre arsimore. Ky lloj komentimi është i kuptueshëm, duke pasur parasysh përvojën dhe profesionalizmin e pamohueshëm të individëve nga njëra anë, por mbase mungesën e praktikës arsimore nga ana tjetër. Nga ana tjetër, kishte vërejtje për disa nga pedagogët që vinin nga fusha akademike që kishin njohuri të pamohueshme teorike, por ajo që përcillej veç më ishte e njohur tashmë për studentët nga ditët e tyre studentore, dhe pyetja është nëse kjo njohuri është praktikisht e zbatueshme.

Kishte nevojë gjithashtu që pedagogët të njihen më mirë me gjithë konceptin e ligjëratave, për tu përfshirë në program në përputhje me rrethanat, në mënyrë që të shmangen dublimi i ligjëratave; përmbajtja e ligjëratave nuk duhet të përbëhet nga citimi ose leximi i neneve nga ligjet; të bëhet një përzgjedhje më e mirë e pedagogëve për sa i përket performancës së tyre - duke mbajtur vëmendjen e dëgjuesve të tyre, inovacioni dhe puna produktive; rekrutimi i ligjëruesve të mos varet nga afërsia e stafit drejtues të AGJPP-së dhe as të mos jetë mënyrë për të ndihmuar financiarisht disa gjykatës.

Për metodologjinë e ligjëratave në AGJPP, 13% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10 dhe 9; 25% kanë dhënë notën 8; 8% me notë 7; 13% me notë 6; 23% me notë 5; 4% me notë 3 dhe 2% me notën 1 (grafiku nr. 5). Në lidhje me këtë pyetje vlera mesatare është 7.

Grafikoni 5.

Në shkallën nga 1 deri në 10 vlerësoni metodologjinë e ligjëratave (mjetet edukative të përdorura, mënyra e transferit të diturive, përpjestimi mes teorisë dhe praksës etj. në AGJPP




Për sa i përket komenteve për këtë pyetje, shpesh përmendje nevoja nga një trajnim i cili do të orientohej drejt praktikës në pjesën teorike të trajnimit. Si sugjerime janë përmendur: përdorimi më i madh i mjeteve të ndryshme arsimore; për të organizuar më shumë gjykime -simulime duke iu referuar njohurive teorike të marra tashmë gjatë pjesës teorike të trajnimit fillestar; të mos lexohen ligje gjatë mësimit teorik; të ushtrohet shkruarja e vendimeve, shqyrtim i vendimeve dhe vlerësim dhe diskutim i cilësisë së vendimit (shprehja gjuhësore, saktësia gramatikore, arsytimi ligjor); të rishikohen, komentohen dhe vlerësohen vendimet e ndryshme ekzistuese gjyqësore dhe vendimet e prokurorit publik; të diskutohen dhe të shkëmbehen përvoja në lidhje me situata problematike dhe / ose situata të paparashikueshme në ushtrimin e funksionit gjyqësor ose të prokurorit; pjesë e pedagogëve të përshtasin ligjëratat dhe ata të përshtaten ato për dëgjuesit e trajnimit (jurist të diplomuar me përvojë pune) dhe jo si më parë, ligjëratat si për studentët në fakultet.

Trajnimi praktik të cilin e ofron AGJPP-ja, 28% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 17% kanë dhënë notën 9; 23% me notë 8; 11% me notë 7; 8% me notë 6; 9% me notë 5 dhe 2% me notën 3 dhe 4 (grafiku nr. 6). Trajnimi praktik është vlerësuar me notë mesatare 8.

Grafikoni 6.

Në shkallën nga 1 deri në 10 vlerësoni trajnimin praktik në AGJPP



Dëgjuesit në numrin më të madh të rasteve janë shprehur me lëvdërata në lidhje me trajnimin praktik dhe mentorët e tyre, duke e konsideruar si pjesën më të rëndësishme të gjithë trajnimit fillestar.

Sugjerimet e dhëna për këtë temë janë: për kandidatët - gjykatës ishin të panevojshëm dy muajt në Prokurorinë publike, për shkak se mungonte ende kohë për praktikë në Gjykatën e apelit që është shumë e rëndësishme; duhet të kihet së paku një praktikë njëmuajore në Gjykatën Supreme; ekziston nevoja trajnimi praktik në Ministrinë e punëve të brendshme të jetë me një kohëzgjatje më të madhe dhe me aktivitete plotësuese për sa i përket njohjes së mënyrës dhe funksionimit të vetë Ministrisë; të futen ushtrime/aktivitete plotësuese në lidhje me sjelljen e gjykatësve dhe prokurorëve publik të ardhshëm në gjykatë; gjatë realizimit të simulimeve të gjykimeve, lëndët për secilin dëgjues të jenë të zgjedhura nga ana e AGJPP-së pa procesverbale të përgatitura paraprakisht; në të ardhmen të përzgjidhen në mënyrë më precize mentorët, ata duhet të jenë gjykatës/prokurorë publik që do të dëshirojnë të përcjellin diturinë e tyre dhe ta mësojnë kandidatin; kandidatët do të mund të mbanin edhe gjykime reale në prezencë dhe nën mbikqyrjen e mentorit, në pajtim me palët.


Për sa i përket dëgjuesve - prokurorë, propozimi është që të kenë dy muaj praktikë në Prokurorinë e lartë publike (në krahasim me 1 muaj) dhe në Gjykatën themelore penale - Shkup (ose në pjesën e materies penale) minimum 2 muaj.

Është kërkuar edhe kontroll më i madh nga ana e AGJPP-së për atë se si të zhvillojë këtë pjesë praktike të mësimin.

Për cilësinë e shërbimeve lidhur me administratën në AGJPP, 32% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 13% kanë dhënë notën 9; 6% me notë 8; 17% me notë 7; 6% me notë 6; 11% me notë 5; 4% /me notë 4; 9% me notë 3 dhe 2% me notë 2 (grafiku nr. 7). Vlera mesatare për këto shërbime është 7,4.

Grafikoni 7.

Në shkallën nga 1 deri në 10 vlerësoni kualitetin e shërbimeve në lidhje me administratën në AGJPP




Në masë të madhe nga përgjigjet e dhëna, tregohet një kënaqësi e madhe për sa i përket cilësisë së shërbimeve dhe gatishmërisë së administratës së AGJPP-së, njëkohësisht duke marrë parasysh kushtet e punës. Të punësuarit gjithmonë kanë qenë në dispozicion dhe ju kanë dalë në ndihmë, por edhe i kanë siguruar materialet dhe informatat e duhura.

Sugjerimet janë: në të ardhmen administrata të jetë më e organizuar, në lidhje me informimet që kanë të bëjnë me teorinë ose praktikën; të silltet njëlloj ndaj të gjithë dëgjuesve dhe të mos i trajtojë si studentë; të përmirësohet komunikimi i brendshëm dhe përsëri të vendoset hierarkia; të rritet numri i personelit të punësuar me qëllim që t’i përgjigjet nevojave.

Për sistemin e mentorimit në punë gjatë trajnimit praktik, 39% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 12% kanë dhënë notën 9; 19% me notë 8; 6% me notë 7; 19% me notë 6; 4% me notë 5 dhe 2% me notën 4. Nuk janë vërejtur vlerësime negative në lidhje me këtë pyetje (grafiku nr. 8). Mënyra e punës me mentor është vlerësuar me notë mesatare 8.25.

Grafikoni 8.

Në shkallën nga 1 deri në 10 vlerësoni sistemin e punës së sistemit të Mentorëve gjatë kohës të punës praktike



Dëgjuesit në AGJPP kanë shprehur kënaqësi edhe për përvojën me sistemin e vendosur me mentor: “Të planifikuar dhe zbatuar në mënyrë të shkëlqyeshme, të gjithë mentorët ishin të përgatitur dhe na e përcollën diturinë dhe përvojën e tyre, ishin të disponueshëm për gjithçka që na nevojitej dhe morën kohë për të na trajnuar, si dhe për të organizuar dhe ndjekur gjykime të simuluar.” ...“Unë jam veçanërisht e kënaqur me mentorin tim të caktuar i cili ndante njohuritë e tij praktike me mua në secilën lëndë si dëgjues dhe mundësonte pjesëmarrjen time në gjykime, në marrjen në pyetje të personave, inspektime në vendngjarje dhe të tjera”.


Rekomandimet e dëgjuesve në lidhje me sistemin e mentorimit ishin që disa mentorë të jenë më të përkushtuar, ose njëherë të përpilohet lista e gjykatësve dhe prokurorëve publik të cilët dëshirojnë të jenë mentorë. Është e preferuar që edhe AGJPP-ja të organizojë trajnime edhe për mënyrën e mentorimit i cili duhet të realizohet dhe atë jo vetëm për atë se si zhvillohen gjykimet dhe si shkruhen vendimet, por edhe të jepen udhëzime të qarta dhe të hollësishme për mentorin që kandidati duhet të mësojë.

Sa i përket raporteve me shkrim të paraqitura në AGJPP mbi punën praktike të kandidatëve, disa të anketuar besojnë se ata nuk mund të pasqyrojnë, në përgjithësi, punën e kandidatëve. Kjo vlen, veçanërisht, për kushtet kufizuese të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimin e aktakuzave, dhe ka një numër i madh vendimesh nga prokurori publik që kërkojnë në një rast të veçantë një angazhim shumë më të madh intelektual dhe kohor se vetë aktakuza.

Nëse shikoni të gjitha vlerat mesatare të këtij grupi pyetjesh, mund të shihet se sistemi i mentorimit është vlerësuar shumë nga dëgjuesit në trajnimin fillestar të AGJPP-së me një mesatare prej 8.25. Me notë të lartë mesatare 8, është vlerësuar edhe puna praktike. Nga këto kategori me notën më të ultë mesatare 6.6 janë vlerësuar ligjëruesit (grafiku nr. 9).

Grafiku nr. 9.

Vlera mesatare të pyetjeve në lidhje me trajnimin



Në pyetjen “A ekzistojnë tema, në aktivitetet e përgjithshme teorike dhe praktike, për të cilat mendoni se do të ishte e dobishme që të përpunohen gjatë edukimit në AGJPP, e që kanë munguar”, dëgjuesit në trajnimin fillestar në lidhje me mbarëvajtjen e edukimit në AGJPP në përgjigjet e tyre kanë përmendur propozimet në vijim:


- Ushtrime për përgatitje me shkrim të vendimeve, puna me lëndë gjyqi dhe prokurorie, sidomos për kandidatët që nuk vijnë nga gjykatat dhe prokuroritë.
- Ushtrime praktike dhe më shumë trajnim për ligjet procedurale, veprimet konkrete dhe praktika në fazat e ndryshme procedurale (LPP dhe ngjashëm);
- Puna me Sistemin informatik për menaxhim automatik të lëndëve gjyqësore (AKMIS);
- Mënyra e organizimit të kohës për shkak të efikasitetit më të madh të gjykatësit;
- Vizita më të shpeshta në institucione të vendosura në Shkup me të cilat organet e gjyqësorit kanë bashkëpunim të detyruar (Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Sektori për hetime kriminale-tekhnike dhe ekspertiza dhe ngjashëm).
- Më shumë punë me tema nga sfera e kriminalistikës.
- Përpunimi i thelluar i moduleve civile dhe kriminale të mjeteve të jashtëzakonshme juridike të cilat janë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e funksionit gjyqësor/prokurorial.

- Kontrolli më i madh dhe evaluimi i mentorëve, me qëllim që të edukojnë mentorë cilësorë. Mentorë të tillë ka, me metoda të shkëlqyera, konkret, në aspekt të praktikës, interesant për ti dëgjuar dhe numri i tyre duhet të rritet, në llogari të atyre të vënë vetëm formalisht për të plotësuar një vend, pa qasje pedagogjike dhe metodologji.

Pjesa tjetër e pyetësorit ka të bëjë me vlerësimin e të anketuarve në lidhje me peshën e provimeve si dhe qëndrimi i tyre në lidhje me objektivitetin e vlerësimit. Ishin të pyetur ndaras për secilin provim në veçanti, përkatësisht pyetjet kishin të bënin me provimin pranues, atë teorik dhe përfundimtar. Si edhe për pyetjet tjera, për provimin përfundimtar është lënë hapësirë për koment, ndërsa përgjigjet e dhëna janë grupuar. Në lidhje me provimin pranues, 53% nga të anketuarit janë përgjegjur se pesha e provimit është i përshtatshëm, ndërsa 47% e të anketuarve e vlerësojnë si të vështirë. Asnjë nga të anketuarit nuk e ka vlerësuar provimin pranues si të lehtë (grafiku nr. 10). Në lidhje me vlerësimin e provimit pranues, 37.7% nga të anketuarit konsiderojnë se është objektiv, 39.6% konsiderojnë se nuk është objektiv, ndërsa 22.6% nga të anketuarit janë përgjegjur se nuk mund të vlerësojnë (grafiku nr. 11).


Grafikoni 10.

Cili është mendimi i juaj për vështirësitë e provimit pranues?



Grafikon 11.


Cili është mendimi i juaj për vlerësimin e provimit pranues?



Kur u pyetën “Se çfarë mendoni për provimin pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit?”, 58% e të anketuarve janë përgjigjur se provimi është i vështirë, 2% janë përgjigjur se është i lehtë dhe 40% është i përshtatshëm (Grafiku nr. 12). Në lidhje me vlerësimin e provimit pas përfundimit të trajnimit, 30% e të anketuarve janë përgjigjur se është objektiv, 43% janë përgjigjur se vlerësimi nuk është objektiv, dhe 27% nuk mund ta vlerësojnë atë (grafiku nr. 13).


Grafikoni 12.

Cili është mendimi i juaj për provimin pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit?



Grafikoni 13.


Cili është mendimi i juaj për vlerësimin e provimit pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit?



Në lidhje me vështirësinë e provimit përfundimtar, 34% e të anketuarve thanë se ishte e vështirë, 4% mendojnë se është i lehtë, ndërsa 62% menduan se provimi përfundimtar është i përshtatshëm (Grafiku nr. 14). Për sa i përket vlerësimin, 41% e të anketuarve mendojnë se vlerësimi i provimit përfundimtar është objektiv dhe pothuajse aq se nuk është objektiv (40%). 19% nga të anketuarit tjerë nuk mund të vlerësojnë objektivitetin e provimit përfundimtar (grafiku nr. 15).


Grafikoni 14.

Cili është mendimi i juaj për rëndësinë e provimit përfundimtar?



Grafikoni 15.

Cili është mendimi i juaj për vlerësimin e provimit përfundimtar?



Sa i përket përgjigjeve të pyetjeve që lidhen me peshën e provimeve, si dhe me objektivitetin e vlerësimeve, mund të konkludohet se për pjesëmarrësit e këtyre trajnimeve provimi më i vështirë ishte pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit, vijon provimi pranues, ndërsa provimi përfundimtar kishte përqindjen më të vogël të vlerësuar si të vështirë nga të anketuarit. Për sa i përket objektivitetit, situata është pothuajse identike për të tre provimet, pra rreth 40% e të anketuarve besojnë se vlerësimi nuk është objektiv në provimet pranuese, teorike dhe përfundimtare. Në lidhje me objektivitetin, numri më i madh i të anketuarve të cilët provimin përfundimtar e kanë vlerësuar si objektiv.

Në lidhje me përvojën dhe sugjerimet për provimin përfundimtar, mendimet janë të ndryshme. Komentet dhe sugjerimet janë sistematizuar si vijojnë:


- Provimi përfundimtar ka qenë korrekt dhe i përshtatshëm për njohurinë e fituar;
- Rezultati i provimit nuk është një pamje reale e njohurive të kandidatit; më shumë është fat - nëse do të keni një pyetje për rast studimi nga ligji ose praktika gjyqësore;

- Nuk kishte asnjë dilemë apo dyshim për ndonjë anshmëri gjatë vlerësimit, por nuk është qëllimi që provimet të jenë të vështira me përgjigje të paqarta ose me zgjedhje të shumëfishta; gjykatësi nuk trajnohet për të marrë pjesë në një kuiz; në ligj ka shpesh më shumë përgjigje të sakta, dhe norma juridike duhet interpretuar dhe zbatuar për një situatë të veçantë të kontestueshme, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes konkrete;
- Kalimi i provimit në formë elektronike për raste studimi dhe provimet me gojë konsiderohen të panevojshme duke pasur parasysh që veç më kemi kaluar provimin pranues dhe provimin pas trajnimit teorik; Unë mendoj se provimi përfundimtar duhet të përbëhet nga një simulim i një gjykimi ose një vendim për të vlerësuar gatishmërinë praktike të kandidatit”;
- Provimi përfundimtar duhet të konsistojë ekskluzivisht nga zbatimi i aftësive dhe njohurive praktike përmes simulimeve të gjykimit dhe përgatitjes dhe referimit të një çështje para komisionit dhe përgatitjen e një vendimi të përshtatshëm gjyqësor ose të prokurorisë me shkrim;
- Praktika ndryshe duhet të largohet nga provimet, përkatësisht duhet të ketë përgjigje të unifikuara e jo të mvaren nga ajo se cili gjykatës ose prokuror publik i ka përpiluar ato, nga cili rajon vjen dhe përgjigja ti përshtatet kësaj;
- Disa dëgjues dyshonin në rangimin përfundimtar të kandidatëve; disa për vlerësimin subjektiv të pjesës gojore të provimit; disa për vlerësimin e përgjigjeve dhe pyetjeve që minusojnë; e theksuan nevojën për publicitet, d.m.th praninë e kandidatëve të tjerë, kur kolegët e tyre hynë në provim gojarisht para komisionit; ka nevojë për të dalluar provimin pranues nga provimi përfundimtar.

Të anketuarit ishin gjithashtu të pyetur të vlerësojnë përfitimin praktik nga trajnimi në AGJPP gjatë pyetjes së aktiviteteve të përditshme të punës ku sipas përgjigjeve të dhëna mund të shihet se numër i njëjtë i të anketuarve (26%) praktikën e kanë vlerësuar me notë 10 dhe 8. 13% e të anketuarve kanë rumbullakësuar notën 9 dhe notën 7; 8% e kanë vlerësuar atë me 6; 11% shënuan 5 dhe 2% shënuan notën 4 (grafiku nr. 16). Nota mesatare e kalkuluar për përfitimin praktik nga trajnimi është 8.

Grafikoni 16.


Në shkallën nga 1 deri në 10 cila është dobja praktike e trajnimit ne AGJPP gjatë kryerjes të aktiviteteve të juaja në punë?



Në pyetjen - “A e shihni se është e dëshirueshme që kursantët, pasi të përfundojnë arsimin e tyre teorik, të ndjekin një karrierë gjyqësore ose prokurorie apo mendoni se duhet të jetë e unifikuar për të gjithë?” 66% e kursantëve në trajnimin fillestar në AGJPP besojnë se të trajnuarit duhet të përcaktohen paraprakisht nëse do të bëhen gjykatës ose prokurorë publik pas diplomimit. Për atë se trajnimi fillestar duhet të jetë i unifikuar për të gjithë dëgjuesit në trajnimin fillestar janë shprehur 32% nga të anketuarit, ndërsa vetëm 2% nga ata janë të pavendosur në lidhje me këtë pyetje. (grafiku nr. 17)

Grafikon 17.

A mendoni që pas mbarimit të mësimit teorik është e pëlqyeshme dëgjuesit të orinentohen drejt karrierës së gjykatësit ose prokurorit, ose mendoni se duhet të jetë e përbashkët për të gjithë?




Në lidhje me ndihmën e mëtutjeshme dhe mbështetjen gjatë kryerjes së detyrave të punës 26% nga të anketuarit janë shprehur se pas mbarimit të trajnimit, nevojitet së paku një vit që të merren lëndë më të lehta, ndërsa 21% nga ata janë shprehur se nevojitet një mentor që do të mbikqyrte

punën dhe do të ndihmonte, 44% nga të anketuarit konsiderojnë se nevojiten të dyja aspektet, ndërsa vetëm 9% konsiderojnë se nuk është e nevojshme as njëra e as tjetra (grafiku nr. 18).

Grafikoni 18.

A egziston nevoja pas përfundimit të trajnimit në AGJPP, në periudhën e dhënë (psh. 1 vit) për ndihmë të mëtutjeshme dhe përkrahje gjatë kryerjes së detyrave të punës?



Komentet e dëgjuesve në lidhje me rolin e ardhshëm të AGJPP-së dhe punën e saj janë dhënë në vijim:

- Në ekzistimin pothuajse 13 vjeçar të AGJPP-së definitivisht ka arsyetuar ekzistimin e saj. Në të ardhmen, definitivisht se duhet të punohet në përmirësimin e cilësisë së trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, shpërndarjen e seminareve sipas rajoneve të apelit si dhe zgjidhjen e çështjes me hapësirën;
- Mendoj se AGJPP-ja edhe deri më tani ka punuar me sukses dhe në përgjithësi prodhon kuadro të përgatitura; edhe më tutje duhet të ngel filteri i vetëm për gjykatësit dhe prokurorët publik të ardhshëm;
- Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar me AGJPP-të të tjera evropiane, me theks në prezencën e rritur të garave ndërkombëtare, vizita studimore dhe ngjashëm;
- AGJPP-ja duhet të bëhet qendra e vetme për tubim të gjykatësve dhe prokurorëve publik, jo vetëm si institucion për trajnim. Është e dëshirueshme që të hapen debate dhe mbledhje me të gjithë gjykatësit dhe prokurorët publik kur përgatiten ndryshimet në ligjet e gjyqësorit, ndërsa AGJPP-ja të bëhet vendi ku do të zhvillohen debate të tilla dhe të veprojnë në kapacitetin e një institucioni i cili rregullisht do të jep konkluzionet nga takimet e këtilla;
- Ekzistojnë kapacitete kadrovike dhe intelektuale për tablimin e AGJPP-së si realitet dhe kjo është pranuar nga publiku i gjerë sepse pavarësia e gjyqësorit si një postulat themelor i një shoqërie demokratike fillon pikërisht nga AGJPP-ja;

- Të vlejnjë kushtet e njëjta për çdo gjeneratë të gjykatësve dhe prokurorëve publik të ardhshëm, me qëllim që të zgjidhen kuadrot më cilësore, si dhe mos të vihen gjeneratat në pozita të ndryshme, përkatësisht në pozita jo të favorshme krahasuar me gjeneratat e kaluara apo të ardhshme. Ndryshimet e shpeshta të ligjeve sjellin deri tek pasiguria ligjore;
- AGJPP-ja duhet të merr ndërtesën e saj, me kushte hapësinore dhe teknike, në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë funksionin e saj në nivel, për një trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm të një cilësie më të mirë. Definitivisht, në të ardhmen është e domosdoshme pajisja dhe vendosja në funksion e një gjykate të improvizuar.

Vërejtje përmbyllëse të përgjigjeve nga dëgjuesit të tanishëm ose të mëparshëm të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”

- Ekziston një konsensus i pandarë midis të anketuarve që AGJPP-ja duhet të ekzistojë, ndërsa 2/3 prej tyre mendojnë se duhet të ishte hapur edhe më herët. Konsiderohet se AGJPP-së është përgjigje e shkëlqyer institucionale e gjendjeve të mëparshme kur janë zgjedhur gjykatës pa asnjë ditë të kaluar në gjykata ose ndonjë edukim tjetër përkatës: “AGJPP-ja është absolutisht e nevojshme dhe ka arsyetuar ekzistimin e saj”.
- Përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve të ardhshëm kryhet përmes AGJPP-së, së cilës i paraprin një proces i ndërlikuar i testimin për pranin të kandidatëve për trajnim fillestar që eliminon ndikimet partiako-politike apo të tjera gjatë selektimit të dëgjuesve të ardhshëm, kjo ndjenjë e pavarësisë profesionale mbahet dhe më tej përmes edukimit e deri tek përfundimi i tij. Pikërisht kjo ndjenjë e padiskutueshme e pavarësisë që kontribuon në integritetin e kuadrove të ardhshme, pasi ata e dinë që ata nuk varen nga ndonjë proces politik ose nga vullneti i individëve për t’u zgjedhur si gjykatës ose prokurorë pas procesit të edukimit në AGJPP.
- Nota mesatare e cilësisë së përgjithshme të trajnimit në AGJPP është 8 (në shkallë prej 1 deri në 10), që don të thotë se dëgjuesit e kanë vlerësuar lartë atë.
- E shikuar në përgjithësi, për sa i përket programit për trajnim, konsiderohet se është mirë i strukturuar dhe i balansuar, por megjithatë, kërkohet më tepër praktikë edukative dhe më pak teori.
- Cilësia e programit dhe lëndët e zgjedhura në AGJPP janë vlerësuar me notë mesatare prej 7.
- Kërkohet që provim të ketë vetëm për lëndët kryesore, ndërsa ato dytësore të dëgjohen vetëm me qëllim të zgjerimit të njohurive të përgjithshme të materies; të ketë më shumë praktikë, sidomos simulim

të gjykimeve; modulet të jenë të përshtatura në varësi prej asaj se nëse dëgjuesi në të ardhmen do të jetë gjykatës ose prokuror; të bëhet rishikimi i ligjëruesve të tanishëm; materiale më të reja dhe më cilësore për BE-në dhe të drejtën ndërkombëtare.

- Ligjëruesit në trajnimin fillestar janë vlerësuar me notë mesatare 6.6.
- Dëgjuesit në përgjithësi lavdëruan aftësinë dhe profesionalizmin e ligjëruesve. Sidoqoftë, ata mendojnë se disa ligjëruesve të praktikës u mungonte qasja metodologjike-pedagogjike, ndërsa profesorëve të universitetit u mungonte përvoja praktike. Kritikohej dhe leximi i drejtpërdrejtë i neneve nga ligji në vend të interpretimit dhe zbatimit të tyre praktik.
- Metodologjia e ligjëratave është vlerësuar me notë të përgjithshme 7.
- Propozohet përdorimi më i madh i një larmie mjetesesh arsimore; për të ushtruar shkruarjen e vendimeve dhe për të organizuar simulime gjyqësore; të shkëmbehen përvoja për raste problematike ose gjykime.
- Trajnimi praktik është vlerësuar me notë mesatare 8.
- Trajnimi praktik vlerësohet në pjesën më të madhe pozitivisht, pasi paraqet pjesën më të rëndësishme të trajnimit fillestar të përgjithshëm. Dëgjuesit bënin sugjerime të ndryshme në varësi të faktit nëse ishin gjykatës të ardhshëm apo prokurorë publik. Ata gjithashtu mendojnë se një numër i vogël i mentorëve nuk ishin të motivuar sa duhet për të punuar me kandidatët.
- Administrata e AGJPP-së për sa i përket cilësisë së shërbimeve që ofron, vlerësohet me notë mesatare prej 7.4.
- Mënyra e punës me mentor është vlerësuar me notë mesatare 8.25.
- Sugjerimet në lidhje me mentorimin janë që vetë mentorët kanë nevojë për training se si ta realizojnë atë; Ekzistojnë vërejtje edhe për raportet me shkrim për punën praktike të kandidatëve, atyre u është kërkuar që të ridizajnohen për të përfshirë të gjitha veprimet aktuale të ndërmarra gjatë trajnimit.
- Temat që nuk janë mbuluar sa duhet në arsim janë: ushtrime për përgatitje të vendimeve me shkrim, puna me lëndë gjyqësore dhe prokurorie, veçanërisht për kandidatët që nuk vijnë nga gjykatat dhe prokuroritë; ushtrime praktike dhe më shumë trajnime mbi ligjet procedurale, veprimet konkrete dhe praktika në faza të ndryshme të procesit (LPP, etj.) dhe puna me sistemin AKMIS.
- Mendimet për peshën e provimit pranues janë plotësisht të ndara, si dhe mendimet se si të vlerësohet provimi.
- Sa i përket peshës së provimit të mbajtur pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit, rreth 60% e konsiderojnë të vështirë, ndërsa pjesa tjetër e konsiderojnë të përshtatshëm. Për sa i përket vlerësimit gjatë provimit, notat janë të shpërndara: 30% mendojnë se është objektiv, 43% mendojnë se nuk është objektiv përderisa 27% nuk mund ta vlerësojnë.

- Rreth 60% nga dëgjuesit mendojnë se provimi përfundimtar është i përshtatshëm, përderisa 34% e konsiderojnë si të vështirë. Për sa i përket vlerësimit, mendimet janë tërësisht të ndara: rreth 40% konsiderojnë se është objektiv përderisa përqindje identike e të anketuarve e mendojnë të kundërtën.
- Dobia nga trajnimi i marrë në AGJPP-së gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme të punës nga pjesëmarrësit e mëparshëm është vlerësuar me një notë mesatare 8.
- Dy të tretat nga të anketuarit konsiderojnë se dëgjuesit duhet paraprkasht të përcaktohen se a do të bëhen gjykatës apo prokurorë pas mbarimit të AGJPP-së.
- Pas mbarimit të trajnimit në AGJPP, 1/4 nga të anketuarit konsiderojnë se nevojitet që në vitin e parë të tyre të punës të marrin lëndë më të lehta, 20% konsiderojnë se ende kanë nevojë për mentor, ndërsa 44% konsiderojnë se u duhen të dyja.

B. Pasqyrë e rezultateve të marra nga pjesëmarrësit në trajnimin e vazhdueshëm të Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik “Pavel Shatev”

Me këtë pyetësor janë përfshirë 85 përdorues të trajnimit të vazhdueshëm në AGJPP. Të anketuarit përgjigjen në një grup prej rreth 30 pyetjesh të hapura dhe të mbyllura. Përgjigjet në pyetjet e mbyllura janë treguar në mënyrë grafike, përderisa përgjigjet në pyetjet e hapura janë përmbledhur dhe të njëjtat janë dhënë në formë narrative. Sipas karakteristikave demografike të grupit, të cilat janë dhënë në tre tabelat e para, në këtë pyetësor janë përgjigjur më shumë gra. Grupmosha më e përfaqësuar është nga 30-49 vjet, ndërsa në lidhje me pozitën në punë/institucioni gjykatësit janë më prezent.

1. Struktura demografike e të anketuarve sipas gjinisë

Gjinia	
Femërore	63%
Meshkuj	37%

2. Struktura demografike e të anketuarve sipas kategorive të moshës

Moshë	
18-29	4%
30-49	56%
50-64	41%


3. Struktura e të anketuarve sipas pozitës së punës dhe institucionit

Pozita e punës dhe institucioni	
Gjykatës	34
Prokuroria themelore publike	26
Bashkëpunorë gjyqi	14
Bashkëpunorë profesional	3
Ministria e drejtësisë	1
Këshilli gjyqësor	1
Gjykata themelore	1
Gjykata civile	1
Konsulent	1
Gjykata supreme	1
Gjykata e lartë administrative	1

Në lidhje me pyetjen e parë, “Si e vlerësoni nevojën për ekzistimin e AGJPP-së”, për 87% të të anketuarve thonë se AGJPP-ja është e nevojshme, përkatësisht, 33% nga dëgjuesit e anketuar në trajnimin e vazhdueshëm konsiderojnë se e njëjta është dashur të hapet që moti, ndërsa 54% nga ta mendojnë se është hapur me kohë. Të tjerët, 13%, janë shprehur se ekzistimi i AGJPP-së është i panevojshëm. (grafiku nr. 1)

Grafikon 1.

Si e vlerësoni nevojën e ekzistimit të AGJPP-së?



Për këtë pyetje është lënë edhe hapësirë për koment, me qëllim që të anketuarit të mund të arsyetonin përgjigjen e tyre. Sipas qëndrimeve të shprehura, pjesa më e madhe (90%) nga të anketuarit të cilët përfaqësojnë një pjesë ose marrin pjesë në trajnimin e vazhdueshëm të AGJPP-së konsiderojnë se ajo është parakushti kryesor për prodhimin e kuadrove cilësore përmes trajnimit fillestar, si dhe përmes trajnimit të vazhdueshëm të kuadrove veç më ekzistuese. Theksohet edhe nevoja që përmes AGJPP-së të bashkëpunohet me institucionet gjyqësore në vend, si dhe institucione të ngjashme për edukim jashtë shtetit me qëllim përgatitjen e plotë teorike

dhe praktike të kuadrove të ardhshme në gjyqësor në drejtim të përfitimit të diturive dhe aftësive të reja, duke përfshirë edhe standardet ndërkombëtare dhe evropiane në sferën e të drejtave të njeriut. Konsiderohet se AGJPP-ja ka arsytuar ekzistimin e saj për krijimin e një profili bashkëkohor, evropian të gjykatësve dhe prokurorëve publik, të motivuar, pavarur me integritet të lartë dhe profesionalizëm, të gatshëm të ballafaqohen me sfidat të cilat i presin në kryerjen e funksionit të tyre, që mund të arrihet vetëm me edukim në këtë institucion. Përmes AGJPP-së, jo vetëm që krijohen kuadro të reja të cilat për momentin janë deficitare dhe të cilët do të jenë bartës të reformave të ardhshme në gjyqësor drejt ndërtimit të një sistemi modern me besim më të madh të opinionit, por hapet dhe debat për tema lidhur me dobësitë dhe mangësitë në sistem, drejtimet për ndryshimet e ardhme, etikën dhe ngritjen e standardeve etike në profesion, si dhe korrupsioni dhe konflikti i interesave dhe luftimi i tyre dhe një sërë temash aktuale dhe komplekse. Disa konsiderojnë se AGJPP-ja duhej të ekzistonte që nga fillimi i proceseve demokratike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht në fillimin e viteve të 90-ta, me çfarë do të evitohesh mundësia për përzjerje të drejtpërdrejtë të politikës në pavarësinë e gjyqësorit.


Një pjesë më e vogël e të anketuarve (10%) kanë diskutuar në mënyrë kritike trajnimin fillestar, për të cilin konsiderojnë se gjatë pranimit në AGJPP u është dhënë përparësi bashkëpunatorëve profesional të punësuar nëpër gjykata dhe prokurori që ata të kenë trajnim më të shkurtër, sepse pjesërisht e njohin dhe kuptojnë punën në gjykata dhe prokurori dhe kështu mund të rikualifikohen lehtë dhe më shpejtë. Kërkohen më shumë ushtrime dhe trajnime praktike, për arsye se kandidatët tregojnë përmirësim në performancë në krahasim me simulimin e parë deri në atë të fundit. Disa konsiderojnë se edhe provimi pranues është shumë voluminoz dhe njëkohësisht përfaqëson devalvimin e provimit të jurisprudencës, përzgjedhja e dëgjuesve nuk është e përshtatshme dhe se i gjithë procesi nuk jep garanca për përzgjedhje cilësore (nuk është i drejtë). Gjithashtu disa konsiderojnë se kandidatët mund vetë të finansojnë trajnimin e tyre, e ajo të zgjatë më së shumti gjashtë muaj, ndërsa në atë periudhë ligjeratat të jenë vetëm praktike (simulim i gjykimit, për të vlerësuar aftësinë për udhëheqje praktike të procedurës gjyqësore dhe ballafaqimin me situata stresuese gjatë gjykimit, aftësinë për përgatitje të vendimeve dhe ngjashëm). Gjithashtu është shprehur shqetësimi për sigurimin e kuadrove cilësore dhe me kohë për punë të rregullt në gjykatë, në mënyrë që të shmanget situata e gjykatave pa gjykatës, ose ulja e disa gjykatave më të vogla, d.m.th. duhet të ketë një plotësim cilësor të gjyqësorit me personel të ri dhe kjo të bëhet në kohën e duhur.

Disa nga të anketuarit konsiderojnë se AGJPP-ja aspak nuk do të duhej të ekzistonte (13%).

Të anketuarit kërkojnë që të vihet një theks më i madh në trajnimin e vazhdueshëm edhe atë përmes trajnimit për standardet, tema aktuale dhe trende më të reja, shqyrtimi i pyetjeve kontestuese, risitë në të punuarit gjatë sjelljes së amendamenteve të ligjeve, interpretimeve dhe zbatimit të dispozitave apo rregullave, shkëmbimi i përvojave, trajnime të reja për KEDNJ dhe praktika e GJEDNJ me qëllim që edhe më shumë të ngritet vetëdija dhe cilësia në punën e prokurorëve publik dhe gjykatësve.

Për sa i përket vlerësimit të cilësisë së përgjithshme të trajnimit në AGJPP, 20% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 25% kanë dhënë notën 9; 17% me notë 8; 14% me notë 7; 7% me notë 6; 13% me notë 5; 1% /me notë 4 dhe 2% me notë 1 (grafiku nr. 2). Duke e shikuar si vlerë mesatare, cilësia e përgjithshme e trajnimit është vlerësuar me notë 7.8 nga ana e pjesëmarrësve në trajnimet e vazhdueshme.


Grafikoni numër 2.
Vlerësoni kualitetin e përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës të trajnimit që e keni/ kishit në AGJPP?



Në tabelat e prezantuara më poshtë janë treguar përqindjet nga notat të cilat i kanë dhënë të anketuarit, në shkallë prej 1 deri në 10, në drejtim të disa aspekteve në lidhje me punën dhe programin e AGJPP-së edhe atë: katalogu i trajnimeve, përzgjedhja e ligjëruesve të vendit dhe nga jashtë, organizimi i trajnimit dhe cilësia e shërbimeve lidhur me administratën në AGJPP. Që të fitohet pasqyra e përgjithshme, për secilën nga pjesët e trajnimit për të cilat është kërkuar vlerësim, është lënë edhe hapësirë për koment. Të njëjtat janë përmbledhur dhe dhënë si plotësim nën secilën nga kategoritë e përmendura.

Katalogu për trajnime në AGJPP, 18% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 20% kanë dhënë notën 9; 22% me notë 8; 14% me notë 7; 6% me notë 6; 11% me notë 5; 5% /me notë 4; 1% me notë 3 dhe 2% me notë 2 (grafiku nr. 3). Që të mund të shihet më lehtë qëndrimi i të anketuarve, për këtë pyetje është përlogaritur vlera mesatare dhe e njëjta është 7.6.

Grafikoni 3.
Vlerësoni katalogun e trajnimeve të AGJPP-së




Sipas komenteve të dhëna, të anketuarit në numër të madh konsiderojnë se Katalogu i trajnimeve është i mirë, i dobishëm, me kohë dhe se përfshin tema interesante dhe aktuale. Kërkohej konsultim i vazhdueshëm me përdoruesit (gjykatësit dhe prokurorët) për atë se cilat tema do të ishin interesante dhe relevante për të ardhmen, duke mos i përsëritur ato. “Katalogu mbulon tema të rëndësishme nga të gjitha fushat, me theks të veçantë në temat dhe çështjet aktuale, dhe është një ide e mirë që të përsëriten ato në termine të ndryshme, në mënyrë që më shumë dëgjues të kalojnë trajnimin varësisht nga angazhimi i tyre i punës. Sugjerimi im në këtë drejtim është që t’u ofrojë mundësi dëgjuesve në një rubrikë të veçantë në faqen e internetit të AGJPP-së për të propozuar tema për përpunim dhe trajnim”- shprehet një i anketuar.

Sugjerimet për përmirësimin e tij përfshijnë: Përfshirje më e madhe e temave nga ligji civil, pasi që konsiderohet se gjithmonë ka më shumë trajnime në fushën penale; Katalogu duhet të botohet çdo tre muaj në mënyrë që të gjitha ndryshimet ligjore, temat dhe praktikatat të mund të ndiqen vazhdimisht; ligjëratat nuk duhet të jenë të thata por të jenë më praktike; të shtohen më shumë trajnime nga KEDNJ-së dhe trajnime për vepra të veçanta penale; trajnim për zbatimin e së drejtës evropiane; më shumë trajnime për mjetet e provës, ekspertiza dhe masat mjekësi ligjore dhe masa të posaçme hetimore (për të kryer trajnime sistematike dhe më gjithëpërfshirëse në koordinim me përfaqësues nga MPB-së dhe zyrtarët e Agjencisë Teknike Operacionale lidhur me mënyrat e reja për zbatimin e masave të posaçme hetimore); të gjendet mënyra për ta bërë Katalogun më të afërt për secilin gjyqtar, të sigurohen më shumë të dhëna për trajnimin, në mënyrë që të përmbushen pritjet e gjyqtarëve dhe/ose të prokurorëve në kohën kur ata aplikojnë për trajnime specifike; të mos përsëriten pedagogët dhe temat; të ketë koordinim më të madh me partnerët e huaj në lidhje me ofertën e llojeve të reja të trajnimit; të gjitha temat e ofruara të janë në dispozicion në faqen e internetit të AGJPP-së; të ketë më shumë tema për çështje administrative; etj.

Sa i përket zgjedhjes së ligjëruesve vendas, të anketuarit i kanë vlerësuar me notë mesatare 7.5, ose treguar veçmas: 20% e të anketuarve janë përgjigjur me notën 10, 20% me notën 9, 21% me notën 8, 8% me notën 7, 5% me notën 6, 14% me notën 5, 7% me notën 4, 1% me notën 3 dhe 2% me notën 2. (grafiku nr. 4)

Grafikoni 4.
Vlerësoni prezantuesit e përzgjedhur vendor në AGJPP-së




Në lidhje me pjesën e hapur të pyetjes, shumica e të anketuarve (80%) shprehin një mendim pozitiv për ligjëruesit vendor në lidhje me profesionalizmin, gatishmërinë dhe kompetencën e tyre. Po ashtu është shprehur kënaqësi që po ofrohen ligjërues nga mjedisi akademik.

Në lidhje me sugjerimet dhe vërejtjet e bëra për këtë çështje, është theksuar që: në të ardhmen të angazhohen ligjërues që kanë mbaruar AGJPP-në kur të plotësojnë kushtet ligjore për këtë; në parim, për të shmangur përsëritjen e shpeshtë të ligjëruesve të njëjtëve edhe pse “disa prej tyre është kënaqësi për të dëgjuar edhe më shumë se një herë në të njëjtën temë”; duhet të ketë më shumë përfaqësim nga praktikues dhe më shumë praktikë sesa teori (të mos lexohen dhe të shpjegohen ligjet); në zgjedhjen e ligjëruesve të mbizotërojë cilësia dhe jo përvoja formale dhe pozita e lartë që ata zënë; ligjëruesit të bëjnë më tepër paralele me praktikën gjyqësore të GJEDNJ dhe/ose të bëjnë analiza krahasuese; të stimulohen ligjëruesit që të përdorin mjete arsimore (pasi që disa nuk e bëjnë këtë); të rivlerësohen ligjëruesit ekzistues bazuar në nivelin e tyre të njohurive dhe ekspertizës, aftësive ligjëruese dhe mësimdhënëse dhe të ngjashme, por gjithashtu edhe të përfshihen ligjërues të rinj që do të kenë cilësi të nevojshme për kryerjen e trajnimit; ata ligjërues të cilët janë profesionistë dhe kompetentë në fushën e lëndës e cila po trajtohet, por që nuk posedojnë të gjithë aftësitë për të transferuar njohuritë e tyre te pjesëmarrësit të cilët duhet nënshtruar trajnimit duhur.

Përzgjedhjen e ligjëruesve të huaj në AGJPP të anketuarit e vlerësojnë me notë mesatare prej 7.9, ose më saktë, 20% e të anketuarve kanë dhënë një notë të shkëlqyeshme 10; 21% janë përgjigjur me notën 9; 30% me notën 8; 13% me notën 7; 4% me notën 6; 2% me notën 5; 5% me notën 4 dhe 4% me notën 2. (grafiku nr. 5)

Grafikoni 5.
Vlerësoni prezantuesit e huaj të përzgjedhur nga AGJPP-ja



Të anketuarit në shumicën e rasteve mendojnë se ligjëruesit e huaj janë të shkëlqyeshëm, kanë njohuri cilësore dhe eksperte - ...“Këtu posaçërisht i kisha theksuar ligjëruesit e zgjedhur që vijnë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara për tema nga sfera e së drejtës penale e që janë veçanërisht interesant, aktiv dhe të hapur për shkëmbimin e përvojave, me punëtori interaktive dhe të dizajnuara mirë me pjesëmarrjen e të gjithë pjesëmarrësve në trajnim, përmes një shumëllojshmërie ushtrimesh, jo vetëm dëgjimi pasiv të teorisë dhe përvojave praktike, por edhe aplikimin e njohurive të marra përmes ushtrimeve të dizajnuara në mënyrë adekuate...”, “... të sillen ligjërues nga Shkolla Kombëtare e Administrimit Francez”.


Në kuadër të vërejtjeve të bëra, konsiderohet se kur ligjëruesit e huaj mbajnë ligjërime duke përcjellur përvojën është gjithashtu e nevojshme që të jenë të pranishëm edhe ligjërues vendas duke dhënë paralele dhe duke bërë krahasime të legjislacionit dhe praktikës së huaj dhe asaj vendase. Kur mbahen ligjërata, duhet të ketë informacione paraprake në lidhje me situatën vendore, përvojat dhe zgjidhjet ligjore, në mënyrë që të mund të ketë diskutim krahasues, ndërveprim dhe vlerësim të përparësive dhe mangësive. “Kam një ndjenjë që disa nga ligjëruesit e huaj nuk e kanë idenë për problemet me të cilat përballen gjyqtarët dhe/ose prokurorët në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që ata nuk e konsultojnë Kushtetutën dhe ligjet e vendit, se ekspertiza e tyre nuk është për temën specifike ... Nuk duhet të fascinohe mi nga fakti që një “i huaj” na ka ardhur si ligjërues, por sa informacione/të dhëna krahasuese ai ose ajo na jep për një temë apo sferë të veçantë, dhe sa shumë, ato informacione/të dhëna, do të na sjellin dobi në punën tonë të përditshme”. Konsiderohet gjithashtu se temat e zgjedhura duhet të përcaktohen, para së gjithash, sipas përparësive dhe nevojave të brendshme dhe mundësisht të kenë zbatim praktik.

Me notë mesatare prej 7.3 është vlerësuar organizimi i trajnimit (hartimi i agjendës, baraspesha midis teorisë dhe praktikës në trajnim, dhe ngjashëm, etj.) Në AGJPP, pra 20% e të anketuarve kanë dhënë një notë të shkëlqyeshme 10; 14% janë përgjigjur me notën 9; 19% me notën 8; 15%

me notën 7; 7% me notën 6; 15% me notën 5; 2% me notën 4; 2% me notën 3; 1% me notën 2 dhe 2% me notën 1. (grafiku nr. 6)

Grafikoni 6.

Vlerësoni organizimin e trajnimeve (përpilimi i rendit të ditës, balansi mes teorisë dhe praktikës gjatë trajnimeve e të ngjajshme) në AGJPP-së.



Sa i përket organizimit të trajnimit, shumica e të anketuarve shprehen të kënaqur, duke theksuar se është arritur një ekuilibër i mirë midis teorisë dhe praktikës.

Sidoqoftë, përsëri theksohet nevoja e mëtutjeshme për prezencën e theksuar të praktikës në përmbajtjen e trajnimit, e cila duhet të mbizotërojë mbi teorinë. Disa besojnë se “metodologjia e mësimdhënies nga ligjëruesit është akoma e dobët, shpesh përdoret PowerPoint prezantimi, kështu që në të ardhmen duhet të organizohen më shumë trajnime mbi metodologjinë e ligjëratave.” Gjithashtu theksohet nevoja për të stimuluar diskutimin dhe debatin mbi temën e zgjedhur dhe ndër të pranishmit - nga “AGJPP-ja përpiqen që të sigurojnë ekuilibrin, por kjo varet nga pjesëmarrësit, se sa janë të interesuar të marrin pjesë në mënyrë aktive në trajnim ...”


Në lidhje me hartimin e rendit të ditës, nuk janë dhënë vërejtje, por besohet se duhet të jetë më fleksibile dhe në kohë të mbulojë tema dhe probleme aktuale, d.m.th. t’i kushtohet më shumë vëmendje praktikës në drejtimit të hapjes së temave, diskutimeve për barazimin e praktikës gjyqësore. Kritikohet edhe fakti se vetë trajnuesit ndonjëherë e ndryshojnë rendin e ditës, duke pasur parasysh që disa nga pjesëmarrësit udhëtojnë nga larg, ose, që kryesisht pjesëmarrësit që vijnë nga Shkupi vijnë vonë dhe largohen më herët, etj. Gjithashtu kërkohet edhe sinkronizim më i mirë i temës midis ligjëruesve që marrin pjesë në trajnim. Në fund, është e domosdoshme që AGJPP-ja të ketë më në fund hapësira me çka plotësohen tërësisht nevojat e stafit dhe të akademikëve.

Për cilësinë e shërbimeve lidhur me administratën në AGJPP, 38% nga të anketuarit kanë dhënë notën shkëlqyeshëm 10; 19% kanë dhënë notën 9; 25% me notë 8; 5% me notë 7; 2% me notë 6; 6% me notë 5; 1% /me notë 4; 2% me notë 2 dhe 1% me notë 1 (grafiku nr. 7). Sipas vlerave mesatare

të llogaritura të këtij grupi pyetjesh, cilësia e shërbimeve të administratës vlerësohet më lartë, me një vlerë mesatare prej 8.4.

Grafikoni 7.

Vlerësoni kualitetin e shërbimeve në lidhje me administratën në AGJPP



Ky vlerësim gjithashtu mund të shihet edhe përmes analizës së pyetjes plotësuese të hapur. Sipas përgjigjeve të dhëna, të gjithë të anketuarit shprehën lëvdën dhe kënaqësi për qëndrimin, profesionalizmin dhe punën e administratës në AGJPP. Është kërkuar rritja e burimeve njerëzore, respektivisht punësime të reja: “Cilësia e shërbimeve është në një nivel të lartë duke pasur parasysh mungesën e stafit në AGJPP, por ekziston nevoja për punësime të reja dhe organizim dhe shpërndarje më të mirë të stafit për të mundësuar përkushtim të plotë në organizimin e një aktiviteti të caktuar. Tani për tani për shkak të numrit të vogël të të punësuarve, disa janë të detyruar që të mbulojnë të gjitha ngjarjet pasi që ndonjëherë pëson edhe cilësia e shërbimeve të ofruara (prania e tyre e vazhdueshme dhe kështu me radhë). Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që të përmirësohen shërbimet e TI-së, të mundësohet lidhja e plotë me internet të një numri më të madh të kompjuterëve në hapësirat ku mbahen ligjëratat, veçanërisht në kontekstin e trajnimeve përmes internetit dhe ngjashëm.”


Sipas përgjigjeve të dhëna pyetjes - “Cilat janë dobësitë e identifikuara ose nevojat arsimore në punën tuaj të përditshme që duhet të adresohen nga trajnimi?” Si dobësi të identifikuara ose temat/nejat arsimore që do të ishin të dobishme në punën e tyre të përditshme në të ardhmen, i kanë përmendur: Praktika e GJEDNJ dhe trajnimet e lidhura me anëtarët e KEDNJ; tema nga sfera e psikologjisë për të kuptuar më mirë sjelljen njerëzore; trajnime që do të barazojnë praktikën e ndryshme të zonave të apelit në vend; ligjëratat nga Gjykata Supreme, veçanërisht për qëndrimet parimore; ekzaminimi i drejtpërdrejtë dhe i kryqëzuar në procedurat penale; tema nga mjekësia ligjore dhe psikiatria forenzike; etika; qendrat e hetimit; krimi i organizuar; afirmimi i programit evropian për edukim mbi të drejtat e njeriut për profesionistët e drejtësisë (HELP); tema më të larmishme nga e drejta civile; mënyrat e trajtimit të kritikave nga publiku,

të folurit publik, sjellja, trajnime praktike përmes ushtrimeve interaktive nga ana e klientit dhe publikut të interesuar kur ekziston një temë në të cilën preket interesi publik; njohuri praktike të procedurës penale; përvoja ndërkombëtare shërbimin ekspert gjyqësor; përmirësimi i gjendjes përmes së literaturës profesionale në gjykata; temat të përzgjidhen sipas nevojave të gjyqtarëve dhe aty ku tregohen rezultate më të dobëta; trajnime për zbatimin praktik dhe zbatimin e proceseve të inovacioneve teknologjike (xhirimet) e proceseve.

Sipas përgjigjeve të dhëna pyetjes - “A e zbatoni atë që e dëgjoni në trajnim?” Mund të shihet se pjesëmarrësit në trajnimet e vazhdueshme përdorin njohuri të përfituari nga procesi i trajnimit, që do të thotë se pothuajse të gjithë kandidatëve trajnimet ju ndihmojnë në punën e tyre të përditshme. Ose, më konkretisht, ata gjithmonë zbatojnë atë që kanë dëgjuar, 18% e të anketuarve, 78% e bëjnë këtë shpesh ose ndonjëherë, dhe vetëm 2% përgjigjen se ata rrallë herë e bëjnë këtë. (grafiku nr. 8)

Grafikoni 8.

A e zbatoni atë që dëgjoni në trajnime?




Të anketuarit raportojnë se trajnimet në të cilat marrin pjesë janë të dobishme, mbase jo gjithmonë, por shpesh herë gjejnë aplikim në punën dhe praktikën e tyre të përditshme. Një interes i veçantë tregohet për jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila gjen zbatimin e saj në punën e tyre të rregullt në varësi të sferës në të cilën ata punojnë. Ata e konsiderojnë trajnimin të dobishëm nëse i kushtohet më shumë vëmendje pjesës praktike përmes ushtrimeve dhe vëzhgimit të praktikës gjyqësore, pasi që nevoja për ta barazuar atë është bërë gjithnjë e më e nevojshme në kohën e fundit. Në këtë rast, është veçanërisht e rëndësishme që të ketë një praktikë dhe veprim të njëtrajtshëm në të gjitha rajonet e apelit dhe të përfitohen pikëpamjet e Gjykatës Supreme - “Në një gjendje të mbiprodhimit të zgjatur të rregulloreve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, aktualiteti i temave të ngritura nga AGJPP-ja është shumë i rëndësishëm. .. pikëpamje të përbashkëta të caktuara në kohë, opinione të bashkërenduara, përfundime nga seminarët dhe në lidhje me zbatimin

e disa dispozitave të paqarta japin një kontribut të madh për drejtësi më të shpejtë dhe me cilësi më të mirë “...”Nëse ligjëruesi jep një qëndrim të qartë, trajnimi është i dobishëm, por shpesh trajnuesi është i pasigurtë, kështu që dilemat dhe mosmarrëveshjet mbeten të diskutueshme edhe më tutje ... trajnimi i vazhdueshëm duhet të përdoret gjithashtu për të ndërtuar dhe barazuar praktikën gjyqësore”.

Është theksuar nevoja për zhillimin e mëtutjeshëm të HELP-programit, përmes së cilës hapen mundësi të mëdha për studimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ në sfera të ndryshme të drejtësisë, e më tutje edhe për zbatimin e së njëjtës si mbështetje për justifikimin e vendimit gjyqësor.

Të anketuarit janë pyetur edhe për qëndrimin e tyre ndaj mësimit elektronik, për 59% të tyre mund të aplikohet ky lloj i të mësuarit, 23% mendojnë se nuk mund të zbatohet akoma, dhe 18% nuk kanë shprehur një mendim për këtë çështje. (grafiku nr. 9)


Grafikoni 9.
Ç’farë mendoni për mësimin elektronik?



Për sa i përket mjeteve mësimore, sipas 8% të të anketuarve, ligjëruesit ofrojnë materiale të mjaftueshme, literaturë dhe praktika mësimore, për 27% ligjëruesit shpesh e bëjnë këtë, ndërsa për shumicën e të anketuarve (53%) ligjëruesit ndonjëherë ofrojnë materiale të mjaftueshme. 10% e mbetur janë përgjigjur se ata rrallë herë marrin mjete mësimore. (grafiku nr. 10)

Grafikoni 10.

A ofrojnë prezantuesit material të mjaftueshëm, literaturë, praktikume, dhe mjete tjera për mësim?



Për të identifikuar trajnimet të cilat kanë ngjallur më shumë interes midis pjesëmarrësve, nga të anketuarit u kërkua të tregojnë një temë të cilën ata veçanërisht e pëlqyen. Të anketuarit renditën temat e mëposhtme ku kanë marrë pjesë në trajnim, ku veçanërisht ju kanë pëlqyer:

- Jurisprudenca e GJEDNJ për tema të ndryshme dhe nene të Konventës: Neni 10 liria e shprehjes; Nenet 3 dhe 5; konfiskimi - Praktika e GJEDNJ dhe devijimet nga praktika vendore; konsistenca e praktikës gjyqësore vendore dhe zbatimi i vendimeve të GJEDNJ; trajnimet për ligjërues për tema të caktuara; Programi HELP, i shoqëruar me trajnimin e trajnerëve dhe metodologjia e trajnimit; promovimi i një udhëzuesi për të cituar praktikën gjyqësore të GJEDNJ.
- Amësia surrogat.
- Dëgjimi kryesor dhe ekzaminimi i tërthortë i organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara.
- Urdhër pagese noteriale me miratimin e Ligjit për noterë.
- Vendimet për ankesë në procedurë penale - shkëmbimi i përvojave nga praktika.
- Ndhima juridike ndërkombëtare në çështjet penale.
- Paraburgimi dhe çështjet e ndërlidhura.
- Ekspertiza.
- Veprat penale - vrasja.
- Marrja në pyetje e dëshmitarëve gjatë hetimit nga prokurori publik, përmes Zyrës Amerikane e Zhvillimit, Ndhimës dhe Trajnimit Prokurorial të Jashtëm.
- Mosmarrëveshjet civile që rrjedhin nga procedurat përmbarimore para agjentëve kompetent të përmbarimit.
- Standardet ndërkombëtare në lidhje me etikën e gjyqtarëve.


- Mbrojtja juridike e qytetarëve për të drejtat e pronësisë intelektuale.
- Trafikimi i qenieve njerëzore.
- Hetim paraprak për një vepër penale.
- Migrim i paligjshëm.
- Modul hyrës për trajnim mbi krimet kibernetike, provat elektronike dhe proceset kriminale në internet.
- Mobingu - ngacmim psikologjik në vendin e punës.
- Abuzimi i pozitës zyrtare dhe autoritetit.
- Konfiskimi i pronës.
- Zbatimi i ligjit të ri për mosmarrëveshjet administrative në përgatitjen e vendimeve dhe trajnim për veprim.
- Masat e veçanta hetuese
- Zbatimi i Ligjit për procedurën civile .
- Zbatimi i LPP-së.
- Oferta e një kontrate të re të ndryshuar para anulimit.
- Ligji Evropian, Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED).
- Krimi nga urrejtja.
- Kostoja e procedurës.
- Shpifje dhe fyerje.
- Abuzimet financiare.
- Përgatitja e aktgjykimeve.

